

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5588
E premte, 28 shtator 2018
çmimi 0.40 €

Liderët shtetërorë llojnë për shtimin e njohjeve dhe anëtarësimin në Interpol



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

KOSOVA SYNON TË ARRIJË MARRËVESHJE NË BALLKAN F. 11

Shkruan:
Hashim THAÇI



KËRKOHEM QË TË BËHET ME SHUMË PËR TË PAGJETURIT F. 6

PËRKRAHJA E AUSTRIËSË PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE, E RËNDËSISHME F. 7

EKONOMI

INVESTITORËT GJERMANË INTERESOHEN PËR SEKTORIN E ENERJISË DHE TË MINIERAVE NË KOSOVË F. 9

ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS RRUGORE NDIKON TË BIZNESET F. 8

KULTURË

FËMIJA I PALINDUR F. 13

Adem GASHI

NGA MONOGRAFIA PËR MASAKRËN E DELIAJVE TË ABRISË SË EPËRME F. 13

Afrim HYSENAJ

SPORT

GËRBESHI: PAS PRISHTINËS, RADHËN E KA GJILANI F. 18

INFANTINO: DYERT E FIFA-S DO TË JENË GJITHMONË TË HAPURA PËR KOSOVËN F. 18

KRYETARI I KUVENDIT TË KOSOVËS, KADRI VESELI, KA VIZITUAR TË ENJTEN MAQEDONINË NË PRAG TË REFERENDUMIT PËR EMRIN E RI

FAQE 3

Kosova fton shqiptarët e Maqedonisë për dalje në referendum

Krahas demokracive perëndimore, edhe Republika Kosovës është pro referendumit të Maqedonisë për çështjen e emrit të ri. Në prag të heshtjes zgjedhore, kryetari i Kuvendit të

Kosovës, Kadri Veseli dhe disa parti politike kanë ftuar shqiptarët e Maqedonisë të votojnë pro marrëveshjes me Greqinë për çështjen e emrit. Sipas tyre, qytetarët e

Maqedonisë të dielën do të vendosin për të ardhmen evropiane, për përparimin dhe për sigurinë e rajonit. "I ftoj bashkëkombësit tanë të dalin e të votojnë masivisht", ka thënë Veseli

ZËVENDËSKRYEMINISTRI FATMIR LIMAJ U KA BËRË THIRRJE SUBJEKTEVE POLITIKE TË JENË UNIKE NË PROCESIN E DIALOGUT KOSOVË - SERBI

FAQE 3

Limaj kërkon nga partitë politike unitet për dialogun me Serbinë

Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë të enjten se çështja e dialogut me Serbinë është temë kombëtare dhe në këtë proces duhet të jenë të përfshira të gjitha forcat politike. "Çështja e dialogut është temë kombëtare dhe jemi të



interesuar që në këtë proces të jenë të përfshira të gjitha forcat politike. Ne duam që të gjithë së bashku ta marrim përgjegjësinë për ta drejtuar vendin tonë. Duam të gjithë së bashku të jemi të bashkuar në përfundim të dialogut të mundshëm me Serbinë", ka thënë Limaj



Nitaj:
Arrestimi i deputetëve, shenjë e diktaturës

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Liderët institucionalë të Kosovës vazhdojnë takimet në margjinat e punimeve të rregullta të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork

Liderët shtetërorë llobojnë për shtimin e njohjeve dhe anëtarësim në Interpol



Me qëllim të lobimit sistematik për rritjen e numrit të njohjeve të Kosovës dhe sigurimin e një mbështetje të fuqishme për anëtarësimin e vendit në organizata ndërkombëtare, zyrtarët shtetërorë të Kosovës kanë vazhduar takimet e nivelit të lartë në margjina të punimeve të rregullta të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork

NATO-s në sigurimin e paqes në Kosovë dhe ruajtjen e stabilitetit në rajon, Evropë dhe botë. "Lidhjet tona historike dhe të veçanta me NATO-n duhet të shndërrohen në një bashkëpunim të mirëfilltë strategjik, përmes anëtarësimit tonë në këtë aleancë. Nga sekretari Stoltenberg kërkova vazhdimin e mbështetjes për FSK-në dhe transformimin e saj në ushtri shumetnike me standardet më të larta", ka deklaruar Thaçi.

Po ashtu, presidenti Thaçi ka takuar edhe presidentin e Zvicrës, Alain Berset, të cilin e ka falënderuar për mbështetjen që shteti zviceran i ka dhënë popullit të Kosovës në periudhën e paralutës si dhe në procesin e lirisë, pavarësisë dhe shtetndërtimit. Ndërkaq kryeministri Ramush Haradinaj ka pasur një diskutim të hapur dhe miqësor me presidentin e Sllovenisë, Borut Pahor, në një takim bilateral që ka zhvilluar në Nju Jork. "Pasi e njoftova për të arriturat e vendit dhe angazhimin për rrugën tonë euroatlantike, nga presidenti Pahor kërkova ta ushtrojë ndikimin e vet dhe të llobojë për anëtarësim sa më të shpejtë të

Kosova dhe Tajlanda me marrëveshje për heqjen e vizave për pasaportat diplomatike

Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, dhe zëvendësministri i Punëve të Jashtme i Mbretërisë së Tajlandës, Virasakdi Futrakul, kanë nënshkruar marrëveshjen dypalëshe për heqjen e regjimit të vizave për poseduesit e pasaportave diplomatike në mes të dy vendeve. Marrëveshja është nënshkruar në kuadër të takimit bilateral të dy përfaqësuesve të lartë shtetërorë në margjina të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork.

Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë dhe në familjen e madhe evropiane", ka treguar Haradinaj.

Kurse ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka bërë me dije të enjten se ka takuar ministrin e re të Punëve të Jashtme të Australisë, Marise Payne. "Pas agjendës zyrtare në selinë e OKB-së takova edhe shumë ministra të jashtëm të vendeve afrikane si ai i Kamerunit, Lejeune Mbella Mbella; atë të Ruandës, Louise Mushikiwabo. Takova dhe Jean Baptiste le Moine, ministër shteti për Evropën dhe Punët e Jashtme

të Francës. Më pas takova në një pritje madhështore shumë personalitete drejtuese të Emirateve të Bashkuar Arabe, por edhe nga vende të tjera", ka thënë Pacolli. Ai ka treguar se ka takuar edhe ministrin e Punëve të Jashtme të Emirateve Arabe, Abdullah bin Zayed Al Nahyan, ministrin e Jashtëm të Libisë Mohamed T. H. Siala, Princin e Kurorës së Norvegjisë, Hakkon Magnus, ndihmëssekretarin e Shtetit për Çështje Ekonomike të EBA, Mohamed Sharaf, ministrin e Jashtëm të Bahrejnit, Shaikh Khaled bin Ahmed bin Mohammed Al Khalifah.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

NJU JORK, 27 SHTATOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, kanë vazhduar takimet e nivelit të lartë në margjina të punimeve të rregullta të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. Presidenti Thaçi së bashku me zëvendëskryeministrin e parë, Behgjet Pacollin, në kuadër të sesionit vjetor të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, kanë zhvilluar një takim me presidentin e Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan. Në këtë takim është biseduar për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit bilateral, për rritjen e shkëmbimit tregtar dhe të bashkëpunimit në fusha të tjera me interes të përbashkët.

Presidenti Thaçi ka falënderuar presidentin turk, Erdogan, për mbështetjen që Turqia i ka dhënë Kosovës në procesin e shtimit të njohjeve dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare. Ai ka marrë mbështetjen e presidentit turk, Erdogan, për procesin e anëtarësimit të Kosovës në Interpol, duke kontribuar kështu në rritjen e sigurisë globale. Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka thënë se do të angazhohet personalisht për shtimin e numrit të njohjeve për Kosovën dhe për procesin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare.

Presidenti Thaçi në Nju Jork ka takuar edhe sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, me të cilin ka biseduar për situatën politike dhe të sigurisë në Kosovë dhe rajon. Ai e ka falënderuar sekretarin Stoltenberg për kontributin e

Mogherini bisedoi me udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor

Nju Jork, 27 shtator - Shefja e politikës së jashtme e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, është takuar në Nju Jork me udhëheqësit e Ballkanit

Perëndimor, duke përfshirë presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministrin Ramush Haradinaj. Zëdhënësjja e Mogherinit, Maja Kocijančiq,

nëpërmjet llogarisë së vet në "Twitter" ka shkruar se ajo ka qenë nikoqire e një tubimi joformal të liderëve të Ballkanit Perëndimor, ku është biseduar për situatën në rajon,

bashkëpunimin rajonal dhe punën për integrimin evropian. Në Nju Jork është duke u zhvilluar punimet Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.



Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj u ka bërë thirrje subjekteve politike të jenë unike në procesin e dialogut Kosovë - Serbi

Limaj kërkon nga partitë politike unitet për dialogun me Serbinë



Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë të enjten se çështja e dialogut me Serbinë është temë kombëtare dhe në këtë proces duhet të jenë të përfshira të gjitha forcat politike. "Çështja e dialogut është temë kombëtare dhe jemi të interesuar që në këtë proces të jenë të përfshira të gjitha forcat politike. Ne duam që të gjithë së bashku ta marrim përgjegjësinë për ta drejtuar vendin tonë, duam të gjithë së bashku të jemi unikë e të bashkuar në përfundim të dialogut të mundshëm me Serbinë", ka thënë Limaj

Për çështjen e dialogut me Serbinë të enjten ka folur edhe kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, gjatë vizitës së tij në Maqedoni. Me këtë rast kryeparlamentari Veseli ka bërë me dije se shteti i Kosovës ka gatishmëri të futet në fazën e fundit të dialogut me Serbinë, në mënyrë që t'i jepet fund çdo mosmarrëveshje mes dy vendeve. Ai është zotuar se me marrëveshjen përfundimtare Kosovë - Serbi nuk do të lejohet të ketë precedent negativ. "Kosova si shtet i pavarur nuk ushqen në asnjë formë pretendime terri-

toriale. Për Kosovën, në këtë fazë është me rëndësi funksionaliteti i institucioneve të saj në tërë territorin. Nuk do të lejojmë që me marrëveshjen me Serbinë të kemi precedent negativ", është shprehur kryeparlamentari Veseli pas takimit me kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi.

Edhe kryeparlamentari Xhaferi ka përshëndetur procesin e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë si dhe përpjekjet e të dyja vendeve për arritjen e marrëveshjes përfundimtare.

**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës dhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, të enjten u ka bërë thirrje partive politike të bashkohen në fazën e fundit të procesit të dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se në këtë dialog të gjithë duhet të jenë të bashkuar meqë, sipas Limajt, temat kombëtare nuk janë tema të pozitës dhe opozitës, por tema të shtetit dhe kombit. Ai ka vlerësuar se vetëm duke qenë të bashkuar dhe unikë në këtë proces Kosova mund të paraqitet seriozisht, e pjekur politikisht si dhe t'i mbrojë interesat përballë Serbisë. "Çështja e dialogut është temë kombëtare dhe jemi të interesuar që në këtë proces të jenë të përfshira të gjitha forcat politike. Ne duam që të gjithë së bashku ta marrim përgjegjësinë për ta drejtuar vendin tonë. Duam të gjithë së bashku të jemi të bashkuar në përfundim të dialogut të mundshëm me Serbinë. Vetëm në këtë mënyrë vendi ynë mund të paraqitet seriozisht, i pjekur politikisht dhe t'i mbrojmë interesat si tërësi. Tema e dia-

logut, temat nacionale nuk janë tema të pozitës dhe opozitës, por janë të shtetit dhe të kombit, prandaj duhet të jemi të bashkuar në këto tema", ka deklaruar zëvendëskryeministri Limaj.

Më tutje, Limaj ka bërë thirrje që të punohet për fuqizimin e shtetit dhe ndërtimin e marrëdhënieve të mira me të gjithë fqinjë, duke respektuar interesat e secilit. Në këtë kontekst, ai ka vlerësuar se Kosova si shtet po rritet, po fuqizohet, po forcohet dhe se është në rrugën e duhur. "Ne duhet të veprojmë ta forcojmë shtetin tonë, pavarësinë e Kosovës, të fitojmë sa më shumë njohje, edhe kjo fabrikë është në funksion të forcimit të shtetit tonë. Do të punojmë në drejtim të afirmimit dhe fuqizimit të shtetit tonë. Do të punojmë fuqishëm që të kemi marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjët, duke respektuar interesat e secilit shtet. Kosova po rritet, po fuqizohet, po forcohet. Në këtë drejtim është edhe transformimi i FSK-së, kështu që jemi në rrugën e duhur", ka thënë Limaj. Këto komente zëvendëskryeministri Fatmir Limaj i ka bërë të enjten në vënien e gurtëmetelit të një fabrike të metaleve në Komunën e Klinës.



Lekaj: Projekti 'Autostrada e Dukagjinit' po merr formë

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka bërë me dije se të enjten kanë mbajtur mbledhjen e parë të Komitetit Drejtues Ndërmëtor, ku edhe kanë themeluar njësinë për zba-

timin e projektit 'Autostrada e Dukagjinit'. "Bashkë me kolegët ministra, të cilët do të jenë të angazhuar për ngritjen e gjigantit infrastrukturor, u zotua se në mesin e vitit të ardhshëm do ta fillojmë ndër-

timin e autostradës 91 kilometërshe, më të gjatën në Kosovë. Istogu, Peja, Deçani, Gjakova, Prizreni, edhe më afër lidhjes!", ka shkruar Lekaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka vizituar të enjten Maqedoninë në prag të referendumit për emrin e ri

Kosova fton shqiptarët e Maqedonisë

Krahas demokracive perëndimore, edhe Republika Kosovës është pro referendumit të Maqedonisë për çështjen e emrit të ri. Në prag të heshtjes zgjedhore, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe disa parti politike kanë ftuar shqiptarët e Maqedonisë të votojnë pro marrëveshjes me Greqinë për çështjen e emrit. Sipas tyre, qytetarët e Maqedonisë të dielën do të vendosin për të ardhmen evropiane, për prosperitetin dhe për sigurinë e rajonit. "I ftoj bashkëkombësit tanë të dalin e të votojnë masivisht", ka thënë Veseli



EPOKA E RE **Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Në prag të referendumit, liderët institucionalë dhe partitë politike të Kosovës kanë ftuar shqiptarët e Maqedonisë që të dielën të votojnë pro marrëveshjes historike me Greqinë për çështjen e emrit. Në përmbyllje të fushatës për referendumin, ata kanë vlerësuar se Maqedonia është para një momenti historik për të ardhmen e popujve të saj, ku qytetarët e këtij vendi do të vendosin për të ardhmen evropiane, për prosperitetin dhe për sigurinë e rajonit. Ditën e fundit të fushatës, për t'i dhënë mbështetje referendumit, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë një vizitë zyrtare në Shkup, ku është takuar me kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi. Pas takimit, Veseli ka thënë se Kosova respekton sovranitetin dhe integritetin e Maqedonisë si dhe vullnetin e qytetarëve të saj për emrin, cili do qoftë ai.

Ai i ka ftuar qytetarët e Maqedonisë t'i thonë po referendumit. "Të dielën, qytetarët

e Maqedonisë nuk do të vendosin vetëm për emrin e shtetit, por votimi pro në referendum është edhe për të ardhmen evropiane të rajonit. Prandaj, i ftoj bashkëkombësit tanë të dalin e të votojnë masivisht. Do të jemi bashkë në rrugëtimin tonë euroatlantik. Prioritet kombëtar i të dy vendeve është integrimi në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Ballkani perëndimor ka vuajtur nga mungesa e prosperitetit dhe kemi mbetur larg nga Bashkimi Evropian për shkak të mosmarrëveshjeve që kanë pasur vendet. Kjo tregon domosdoshmërinë e vendim-marrjes politike, në mënyrë që vendet tona të lëvizin më shpejt drejt Bashkimit Evropian. Kjo është arsyeja pse ne i japim përkrahje marrëveshjes midis Maqedonisë dhe Greqisë për çështjen e emrit", ka thënë kryeparlamentari Veseli.

Kurse kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, ka deklaruar se të dy vendet do ta shtojnë bashkëpunimin. "Bashkëpunimi midis dy vendeve tona duhet të shtohet. Kuvendi i Maqedonisë ka formuar një grup parlamentar për

bashkëpunim me Kuvendin e Kosovës. Përsërisin mbështetjen e ndërsjellë në procesin e integritetit euroatlantik", ka thënë Xhaferi.

Ky i fundit ditën e enjte ka mbajtur një konferencë për media, me ç'rast ka bërë thirrje që qytetarët të dalin dhe të votojnë më 30 shtator. "Vendimi pozitiv i qytetarëve më 30 shtator do të thotë hapje e dyerve të

NATO-s dhe të Bashkimit Evropian. Kjo do t'i mundësojë shtetit tonë siguri, rrugë të hapura për qytetarët tanë, më shumë investime të huaja, hapje të vendeve të reja të punës, treg më të madh për plasimin e prodhimeve vendore, mundësi për përparimin e gjeneratave të reja. Referendum i suksesshëm do të thotë shtet juridik, reforma në gjyqësi dhe sundim i tërësishtëm i të drejtës. Me një fjalë, jetë më e mirë për të gjithë ne dhe për gjeneratat e ardhshme. Me rezultatin pozitiv më 30 shtator, Maqedonia do të bëhet partnere e barabartë në Aleancën e NATO-s dhe do të hapet rruga për aderimin e shtetit tonë në shtëpinë e për-bashkët evropiane", ka thënë kryeparlamentari i Maqedonisë, Talat Xhaferi. Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) u ka bërë thirrje shqiptarëve të Maqedonisë të marrin pjesë në referendum. Nëpërmjet një komunikate për medie kjo parti ka bërë me dije se ka ndjekur me kujdes të madh të gjitha zhvillimet lidhur me procesin e ndryshimit të emrit të Republikës së Maqedonisë si dhe ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me

përfaqësuesit institucionalë dhe politikë të shqiptarëve të Maqedonisë. Sipas kësaj partie, të dielën qytetarët e Maqedonisë do të vendosin për të ardhmen evropiane të vendit të tyre, për prosperitetin dhe për sigurinë e rajonit tonë. "LDK-ja vlerëson se është në interesin jetik të shqiptarëve të Maqedonisë dhe në interesin e shqiptarëve kudo që janë, që shqiptarët e Maqedonisë të dielën të marrin pjesë masivisht në referendum dhe të votojnë pro marrëveshjes historike", është thekuar në komunikatë, duke u bërë thirrje shqiptarëve të Maqedonisë që këtë moment historik ta përdorin në interesin e tyre dhe në të mirë të së ardhmes evropiane të shtetit të tyre.

Kurse Partia Socialdemokrate (PSD) ka vlerësuar se zbatimi i kësaj marrëveshjeje midis Maqedonisë dhe Greqisë ka një rëndësi të veçantë për bashkëpunimin e domosdoshëm rajonal, në kushte barazie dhe sipas parimeve të fqinjësisë së mirë. "Dita e 30 shtatorit duhet të jetë një kundërpërgjigje popullore edhe ndaj elitave shoviniste e shtypëse në të dy vendet, të cilat e përdorin që gati 30 vjet



donisë për dalje në referendum



Marrëveshja ka shkaktuar ndasi të thella në Maqedoni

Me marrëveshjen e arritur pala maqedonase ka pranuar se Maqedonia e sotme dhe maqedonasit që jetojnë në këtë vend nuk kanë lidhshmëri me maqedonasit antikë, sikur që nuk ka lidhshmëri as gjuha e saj, për të cilët në marrëveshje thuhet se është pjesë e grupit të gjuhëve sllave.

Përmbajtja e kësaj marrëveshje ka shkaktuar ndasi të thella në Maqedoni. Dy blloqet, pushteti dhe opozita, forcën e tyre politike në fushatën trejavore e kanë përqendruar në daljen apo mosdaljen e qytetarëve në votime, por edhe në atë nëse marrëveshja mbron ose jo interesat kombëtare e shtetërore. "Kjo marrëveshje është ajo për të cilën kanë luftuar baballarët tanë, gjyshërit e stërgjyshërit tanë. Përfundimisht, ne do të kemi shtet të pranuar nga të gjithë.

Askush më nuk do ta kontestojë vendin tonë. Gjuha maqedonase do të ekzistojë sikur edhe kombi, kultura e tradita jonë. Maqedonia si asnjëherë më parë ka miq ndërkombëtarë dhe ajo është dëshmuar me vizitat e shumta që kemi pasur gjatë kësaj periudhe për të na inkurajuar se jemi në rrugën e vërtetë, që garanton të ardhmen evropiane dhe perspektivë për qytetarët", ka deklaruar kryeministri maqedonas Zoran Zaev në njërin nga tubimet e fundit të fushatës.

Edhe pse referendumi është konsultativ, partitë qeverisëse të udhëhequra nga kryeministri Zoran Zaev synojnë që dalja të jetë mbi 50 për qind, por edhe sikur kjo të mos arrihet, kryeministri ka thënë se çështja do t'i

kalojë Kuvendit për hapa të mëtejshëm.

Ndërsa opozita e udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja si dhe presidenti i shtetit, Gjorge Ivanov, marrëveshjen për emrin e kanë quajtur kapitulluese. "Nëse ky referendum kalon, pas disa viteve Greqia sërish do të na kushtëzojë dhe kërkesa të tjera dhe në atëherë do të jemi me emër të ri, sikur edhe identitetet tjetër, histori e arsim. Nëse referendumi kalon dhe miratohet Marrëveshja me Greqinë, ne me këtë do ta flakim referendumin e vitit 1991. Nëse referendum i atëhershëm ishte për pavarësi dhe shtet sovran, gjuhë, kulturë dhe identitet maqedonas, ky referendum do të jetë për shuarjen e kombit, të gjuhës dhe identitetit", ka deklaruar kryetari i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickovski.

Për t'i dhënë mbështetje këtij referendum gjatë fushatës Maqedoninë e kanë vizituar shumë zyrtarë të lart të admin-

istratës amerikane, dhe udhëheqës të e BE-së. Për këtë qëllim, Shkupin e kishte vizituar edhe kacerja gjermane Angela Merkel dhe liderë të tjerë evropianë.

Të enjten në mesnatë ka hyrë në fuqi heshtja para votimit të së dielës për referendumin, i cili jo vetëm nga Qeveria në Shkup, por edhe nga personalitete të larta evropiane dhe amerikane është cilësuar historik. Rreth 1.8 milion votues janë ftuar të deklarohen për marrëveshjen me Greqinë, që parasheh riemërtimin e vendit në Republika e Maqedonisë së Veriut, me çka do t'i jepej fund kontestit 27-vjeçar me fqinjin jugor.

Greqia, e cila është anëtare e Bashkimit Evropian dhe e NATO-s, ka kushtëzuar pranimin e Maqedonisë në këto organizata me ndërrimin e emrit të saj pasi, sipas Athinës, Maqedonia ka pretendime territoriale dhe kulturore ndaj rajonit grek me të njëjtin emër.

çështjen e emrit të Maqedonisë për t'i fshehur dhe legjitimuar politikën e tyre përjashtuese, eksploative dhe diskriminuese. Dita e 30 shtatorit duhet të dëshmojë se vetëm qasja progresive dhe politikën progresive garantojnë paqen e qëndrueshme dhe mundësinë e barabartë për zhvillim për të gjithë", është thënë në komunikatën e PSD-së.

Ahmeti: 30 shtatori, çelësi që hap dyert e NATO-s dhe të BE-së

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, në prag të referendumit të 30 shtatorit, ka thënë se ky 30 shtatori i bënë bashkë, shqiptarë e maqedonas, turq e romë, vllahë e serbë, bashkë me të gjithë të tjerët, për realizimin e ëndrrës së përbashkët për Maqedoninë euroatlantike. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se më 30 shtator shënohet vija midis së kaluarës dhe ndërtimit të së ardhmes, midis regresit dhe progresit, midis integritimit dhe izolimit, midis Lindjes dhe Perëndimit. "Në përmbyllje të fushatës për

referendum e së dielës, e cila ka filluar para gati tri dekadave me përcaktimin tonë për integrim në NATO dhe në Bashkimin Evropian, më lejoni t'ju drejtohem edhe një herë për rëndësinë e votës suaj më 30 shtator! 30 shtatori i vitit 2018 nuk përsëritet më! 30 shtatori është shansi i fundit i gjeneratës sonë për ta siguruar të ardhmen e sigurt të fëmijëve tanë dhe të gjeneratave pas nesh. Më 30 shtator shënohet vija midis së kaluarës dhe ndërtimit të së ardhmes, midis regresit dhe progresit, midis integritimit dhe izolimit, midis Lindjes dhe Perëndimit!", ka shkruar Ahmeti.

Ai ka bërë me dije se të gjitha demokracitë perëndimore, ashtu siç qëndruan pranë Maqedonisë në dy dekadat e fundit, edhe sot janë në përkrahje të referendumit. "Vota jonë më 30 shtator është përcaktim i secilit prej nesh për paqe, siguri dhe stabilitet të qëndrueshëm, për marrëdhënie të mira ndëretnike dhe ndërfaqjësore, për një rajon të stabilizuar, për sundim të ligjit e për shtet të së drejtës, zhvillim ekonomik, për më shumë investime vendore dhe të huaja, për mirëqenie

shoqërore! Pak gjenerata kanë mundësi që të marrin vendime kaq të guximshme dhe kaq të rëndësishme për brezat që do të vijnë, prandaj ne kemi përgjegjësi historike që më 30 shtatori ta bëjmë hapin e duhur, të votojmë 'për' integrim në Aleancën Veriatlantike dhe Bashkimin Evropian! Më 30 shtatori nuk ka humbës. Ka vetëm fitues! Vota jonë më 30 shtatori është çelësi që hap jo vetëm dyert e NATO-s dhe të BE-së, por edhe të jetës më të mirë për të gjithë ne! Këtë betejë të përbashkët do ta ngadhënjë sepse ne jemi të bindur se qytetarët do ta marrin vendimin e duhur për Maqedoninë evropiane", ka



Limaj në Klinë fton mërgatën të investojë në Kosovë

KLINË, 27 SHTATOR (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka marrë pjesë në vënien e një gurthemeli të një fabrike e cila merret me përpunimin e metaleve në fshatin Grabanicë të Komunës së Klinës. Me këtë rast Limaj ka thënë se ky është moment i rëndësishëm jo vetëm për Klinën, por edhe për Kosovën. Limaj ka përgëzuar investitorin Ahmet Faniqi i cili jeton dhe punon në Gjermani. Sipas Limajt, ky është shembulli më i mirë që tregon se diaspora është e lidhur me atdheun. "Pas një

punë të madhe atje janë të interesuar për të investuar në vendlindje dhe janë të interesuar që përvojën dhe kapitalin që kanë arritur me mundësi të përpjekje ta kthejnë dhe ta investojnë në vendin e tyre", ka thënë Limaj.

Më tutje, ai ka thënë se janë dëshmitarë të fillimit të punimeve të një projekti të madh i cili kap shifrën e mbi një milion eurove ku do të punësohen një numër i madh i qytetarëve të kësaj zone. "Ju sigurojmë se qeveria do të jetë mbrapa për ta mbështetur çdo iniciative

të tillë konkrete që hap mundësinë e investimeve të reja dhe i hap perspektivë të re vendit tonë", ka deklaruar Limaj. Ai i ka ftuar bashkatdhetarët tanë që jetojnë anekënd Evropës të mos hezitojnë dhe të investojnë në Kosovë nëse e shohin në interesin e tyre. Kosova, ka thënë Limaj, ka mundësi dhe potencial dhe qeveria do të jenë përkrah tyre. Kurse investitori Ahmet Faniqi është shprehur i lumtur me fillimin e punimeve të kësaj fabrike. Ai ka falënderuar Qeverinë lokale dhe qendrore për mbështetjen e dhënë.



Kërkohet të bëhet më shumë për të pagjeturit

Adelina Hasani nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka theksuar se që nga përfundimi i luftës në Kosovë çështja e më shumë se 1 600 personave të pagjetur ende nuk është zgjidhur dhe se sfida më e madhe për institucionet dhe shoqërinë e Kosovës edhe 18 vjet pas luftës mbetet zbardhja e fatit të personave të pagjetur



EPOKA E RE **Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në bashkëpunim me Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, ka mbajtur të enjten tryezën e diskutimit "Si duhet të zgjidhet çështja e personave të pagjetur në Kosovë", pjesë e së cilës ishin përfaqësues të institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile që merren me çështjen e të pagjeturve dhe të drejtat e njeriut.

Në hapje të këtij diskutimi Adelina Hasani nga KDI-ja ka theksuar se që nga përfundimi i luftës në Kosovë çështja e më shumë se 1 600 personave të pagjetur ende nuk është zgjidhur dhe se sfida më e madhe për institucionet dhe shoqërinë e Kosovës edhe 18 vjet pas luftës mbetet zbardhja e fatit të

personave të pagjetur dhe, po ashtu, format e deritanishme të trajtimit të këtij problemi. Kurse anëtarja e Komisionit Parlamentar për Personat e Pagjetur, deputetja nga Lëvizja Vetëvendosje, Saranda Bogujevci, ka theksuar se sa i përket çështjes së të pagjeturve ka mungesë të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punëve ndërmjet institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Sipas saj, këto të fundit duhet t'ua bartin kompetencat vendorëve. Bogujevci ka shtuar se institucionet ndërkombëtare duhet të kenë vetëm rol mbështetës për çështjen e të pagjeturve. Ajo ka potencuar se për të mbetet shqetësuese shuarja e Institutit për Hulumtime të Krimeve të Luftës. Ajo ka kërkuar rifunksionalizimin e këtij instituti duke e konsideruar tejet të rëndësishëm.

Jahja Lluka, këshilltar i kryeministrit të Kosovës, ka pohuar se

Qeveria ka bashkëpunim shumë të ngushtë me të gjitha komisionet vendore dhe ndërkombëtare lidhur me këtë çështje. Përveç familjarëve të të zhdukurve shqiptarë, ai ka thënë se kanë kontakte të vazhdueshme edhe me familjarët serbë në Kosovë që kanë familjarë të zhdukur. Lluka ka folur

edhe për problematikën e numrit të madh të mbetjeve mortore në morgun e Prishtinës. Sipas tij, një numër i madh i tyre nuk kanë të bëjnë me mbetjet mortore të luftës së fundit dhe se së bashku me Komunën e Prishtinës kanë marrë iniciativë që për mbetjet mortore të cilat nuk i takojnë

asaj periudhe të caktohet një lokacion në varrezat e qytetit ku edhe duhet të vendosen. Gjatë tryezës u prezantua edhe një hulumtim parlamentar i realizuar nga KDI-ja që ka analizuar nismat për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur si dhe cilat janë praktikatat e vendeve të dala nga konflikti.

Testi i maturës, temë diskutimi mes ministrit Bytyqi dhe drejtoreshës së ETS-së

PRISHTINË, 27 SHTATOR (ER) - Gjatë vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, ka takuar drejtoreshën e ETS-së, Shannon Ashpole Litton dhe ekipin e saj.

ETS është organizatë e cila bashkëpunon me Qeverinë e ShBA-së për përpilimin e teksteve të nivelit shtetëror, siç

janë Toefl, Ect e të tjerë. "Në këtë takim biseduam për format e përpilimit dhe për rëndësinë e këtyre testeve. E informova rreth Testit të Maturës dhe testet e tjera që realizohen në Kosovë, për problemet që ekzistojnë qoftë për përpilimin e tyre, apo edhe për kontrollin e testeve. U pajtuam që në kohën e hapjes së diskutimeve publike në Kosovë

rreth këtyre çështjeve, të jetë edhe një ekip i ETS-së pjesëmarrës në këto diskutime, për të ndihmuar me përvojën dhe praktikën e tyre, e cila daton nga viti 1947", ka thënë Bytyqi. Ai ka shtuar se për Kosovën është një lajm i mirë që ETS të jetë pjesë e këshilldhënies për të gjitha llojet e testeve, qoftë të nivelit parauniversitar, qoftë të arsimit të lartë.



Ministri Federal i Austrisë për Çështjet e Bashkimit Evropian, Gernot Blumel, ka qëndruar për vizitë në Kosovë

Përkrahja e Austrisë për liberalizimin e vizave, e rëndësishme

Ministri Federal i Austrisë për Çështjet e Bashkimit Evropian, Gernot Blumel, gjatë qëndrimit të tij në Prishtinë, ka vlerësuar angazhimin e Kosovës për përmbushjen e kushteve nga udhërrëfyesi si dhe masave të MSA-së. Ai ka ofruar përkrahjen e Austrisë në proceset që po kalon Kosova. Këto komente ministri austriak i ka bërë pas takimeve të ndara me zëvendëskryeminstren Enver Hoxhaj dhe ministren e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha



Edhe ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, të enjten ka pritur në takim ministrin Federal të Austrisë për Çështjet e Bashkimit Evropian, Gernot Blumel, me bashkëpunëtorë, i cili njëherësh përfaqëson presidencën austriake të Këshillit të Bashkimit Evropian. Hoxha ka falënderuar ministrin Blumel për mbështetjen austriake për Kosovën në të gjitha fazat e shtetformimit dhe shtetndërtimit, duke u fokusuar në përkrahjen rreth lib-

eralizimit të vizave si dhe fuqizimin e marrëdhënieve bilaterale. "Ne çmojmë jashtëzakonisht shumë kontributin dhe përkrahjen e Austrisë, në veçanti rreth liberalizimit të vizave. Në tashmë kemi filluar fushatën informuese për këtë proces të rëndësishëm për Kosovën dhe qytetarët e saj. Ky është sukses i përbashkët me vendet mike si Austria e cila ishte vazhdimisht përkrah qytetarëve të Kosovës. Kosova ka nevojë për përkrahjen e mëtejme të Austrisë,

sidomos në këtë fazë, duke përsheptuar vendimmarrjen për liberalizimin e vizave në mënyrë që ky proces të përmbillet gjatë presidencës austriake", ka deklaruar Hoxha.

Ministrja Hoxha ka theksuar përkushtimin për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit si dhe Agjendën Evropiane të Reformave, ERA 2, e cila parashikon vijimin e zbatimit të reformave me vëmendje të veçantë për reformën e administratës publike.

**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Ministri Federal i Austrisë për çështjet e Bashkimit Evropian, Gernot Blumel, të enjten ka qëndruar për vizitë në shtetin e Kosovës, ku është pritur në takime të ndara nga zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj dhe ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha. Me këtë rast ministri austriak Gernot Blumel ka vlerësuar angazhimin e Kosovës për përmbushjen e kushteve nga udhërrëfyesi si dhe masave të MSA-së. Ai ka ofruar përkrahjen e Austrisë në proceset që po kalon Kosova.

Ndërsa zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj, duke e falënderuar ministrin për mbështetjen në rrafshin bilateral dhe multilateral të Austrisë për Kosovën, ka thënë se vendi ynë është i përkushtuar që këto marrëdhënie të shkëlqyera të vazhdojnë t'i shtojë edhe në rrafshin

ekonomik, kulturor dhe fusha të tjera të interesit të përbashkët. Hoxhaj e Blumel kanë folur edhe për procesin e liberalizimit të vizave, duke theksuar se mbështetja e Austrisë në këtë proces është jashtëzakonisht e rëndësishme për Kosovën. "E falënderova mikun tim, ministrin Blumel, për mbështetjen e vazhdueshme të Austrisë për Kosovën dhe theksova se përkrahja e Austrisë për Kosovën në procesin e liberalizimit të vizave është jashtëzakonisht e rëndësishme në këtë fazë të fundit të këtij procesi", ka thënë Hoxhaj.

Po ashtu, ata kanë diskutuar edhe për perspektivën evropiane të Kosovës dhe të Ballkanit Perëndimor, si dhe për dialogun Kosovë - Serbi, me ç'rast Hoxhaj ka theksuar se marrëveshja finale duhet ta përmbajë njohjen e ndërsjellët mes dy shteteve dhe ta garantojë anëtarësimin e Kosovës në Kombet e Bashkuara.

Muharrem Nitaj: Arrestimi i deputetëve, shenjë e diktaturës

Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Muharrem Nitaj, ka thënë se dy deputetët, Shkumbin Demaliaj dhe Milaim Zeka, janë arrestuar vetëm për shkak të fjalëve që i kanë shprehur në televizion. Sipas tij, arrestimi i tyre ka qenë krejtësisht i panevojshëm pasi ata nuk kanë bërë as edhe një veprim të vetëm që mund të cilësohej kërcënim. "Këto janë shenja të diktaturës, jo të drejtësisë. Deputetët Demaliaj e Zeka duhet të lirohen menjëherë dhe Prokurori i Shtetit duhet të japë sqarime", ka thënë Nitaj



**EPOKA
ERE** Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Me urdhrë të Prokurorisë Themelore të Prishtinës të enjten është ndaluar deputeti i Kuvendit të Kosovës, Shkumbin Demaliaj, për veprën penale kanosje. Ditë më parë anëtar i partisë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Demaliaj kishte përdorur gjuhë të ashpër kundër ish-prokurorit Elez Blakaj, i cili ka hetuar më parë çështjen e "Listës së veteranëve". Ndaj ndalimit të deputetit Shkumbin Demaliaj dhe caktimit të masës së paraburgimit për një muaj për deputetin e Kuvendit të

Kosovës, Milaim Zeka, ka pasur reagime nga deputetë dhe përfaqësues të partive politike.

Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Muharrem Nitaj, ka thënë se dy deputetët, Shkumbin Demaliaj dhe Milaim Zeka, janë arrestuar vetëm për shkak të fjalëve që i kanë shprehur në televizion. "Unë personalisht kam vërejtjet e mia për gjuhën që ata e kanë përdorur, por a mund të cilësohen kanosje dhe kërcënim vetëm qëndrimet e tyre publike, sado të pamatura qofshin ato? Vlerësoj se arrestimi i tyre ka qenë krejtësisht i panevojshëm sepse ata nuk kanë bërë as edhe një veprim të vetëm që mund të cilësohej kërcënim. Kur

prokuroria e Shtetit i paska rregulluar krejt punët e veta, saqë paskan ardhur në radhë të arrestohen deputetët vetëm aq flasin në studio televizive", ka thënë Nitaj.

Ai ka shtuar se nuk janë arrestuar kërcënuesit e denoncuar, nga viktimat që më pas janë vrarë, kurse tash po arrestohen deputetë pse e teprojnë me fjalë. "Këto janë shenja të diktaturës, jo të drejtësisë. Deputetët Demaliaj dhe Zeka duhet të lirohen menjëherë dhe Prokurori i Shtetit duhet të japë sqarime. Nuk mbyllet deputetët

për një fjalë goje. A keni dëgjuar të ketë ndodhur diçka e tillë në botë, përpos në diktaturë, apo ju jeni të parët që e keni zbuluar", ka deklaruar në reagimin e tij deputeti Muharrem Nitaj.

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Gani Dreshaj, ka folur për arrestimin e deputetëve Shkumbin Demaliaj dhe Milaim Zeka. "Prokuroria e Kosovës ka mjaft punë për të bërë, ka mjaft kriminelë që sillen në rrugët e Kosovës të lirë e kapadai. Nuk është e lehtë ta mbyllësh një

deputet të zgjedhur nga vota e popullit veç pse ai ka shprehur mllëfin e tij në studio televizive ndaj situatave të turpshme të krijuara kohët e fundit. Deputeti kudo në botë, në shtetet demokratike, respektohet dhe gëzon imunitet, ndërsa tek ne arrestohet e lirohet me teke të dikujt", ka shkruar Dreshaj.

Gjykata Themelore në Prishtinë të enjten ka miratuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për caktimin e masës së paraburgimit për një muaj për deputetin e Kuvendit të Kosovës, Milaim Zeka, përkatësisht deri më 26 tetor të këtij viti. Zeka, pjesëtar i partisë Nisma Socialdemokrate, dyshohet për kanosje ndaj Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Kosovës, Afrim Shefkju, i cili ka ngritur aktakuzë kundër Zekës në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Pala ka të drejtë ankese kundër këtij vendimi në Gjykatën e Apelit. Policia e Kosovës me vendim të Prokurorisë Themelore të Prishtinës kishte ndaluar deputetin Zeka të mërkurën dhe e kishte dërguar në mbajtje për 48 orë.

O'Connelli e Begolli flasin për rimëkëmbjen e Telekomit të Kosovës

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O'Connell, ka pritur në takim kryeshefin ekzekutiv të Telekomit të Kosovës, Gent Begollin, me të cilin ka diskutuar për ecurinë e hapave të ndërmarrë për rivitalizimin e ndërmarrjeve publike, veçanërisht për rimëkëmbjen biznese dhe teknologjike të Telekomit. Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Gent Begolli, ka informuar ambasadorin britanik për masat dhe strategjinë e re të kompanisë që ai drejton, në drejtim të promovimit të produkteve të reja, gjetjes së mundësive të bashkëpunimit me investitorë ndërkombëtarë si dhe avancimin e ideve kreative për t'i tejkuluar vështirësitë me të cilët aktualisht ballafaqohet tregu i operatorëve të komunikimeve

elektronike në Kosovë.

Duke e falënderuar ambasadorin britanik, Begolli ka theksuar nevojën e konsolidimit të sektorit ekonomik në vend, me theks të veçantë orientimin e investimeve të duhura në sektorin publik që mund të ndikojnë në rritjen e përgjithshme ekonomike të vendit. "Përkrahjet si këto për punën që kemi nisur ta bëjmë në Telekom, pavarësisht prej sfidave që kemi dhe që na presin, përbën një motiv shtesë për ta ndryshuar gjendjen aktuale në Telekom dhe për të ofruar një gamë të larmishme produktesh dhe shërbimesh për të gjithë qytetarët e Kosovës", ka thënë Begolli.

Në këtë takim është theksuar se zhvillimi dhe forcimi i ndërmarrjeve të mëdha, siç është Telekom i Kosovës, është në të njëjtën kohë edhe forcim dhe mirëqenie ekonomike dhe sociale për tërë ekonominë e Kosovës.



MTI-ja shënon Ditën Botërore të Turizmit me aktivitete në Pejë

PEJË, 27 SHTATOR (ER) - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka shënuar të enjten Ditën Botërore të Turizmit me disa aktivitete të organizuara në bashkëpunim me Komunën e Pejës dhe me shoqatat turistike të Kosovës.

Hapjen zyrtare të këtij aktiviteti e bëri ushtruesja e detyrës së ministres së Tregtisë dhe Industrisë, Arbëreshë Krasniqi. Ajo ka theksuar se ministria që ajo e drejton i ka dhënë prioritet zhvillimin në turizmit me gjëra konkrete, duke themeluar Departamentin e Turizmit. "Për të dëshmuar përkushtimin ndaj turizmit, si sektor strategjik i zhvillimit ekonomik, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka themeluar Departamentin e Turizmit, për të mundësuar që të iniciohen dhe zhvillohen politika të favor-

shëm si dhe për ta promovuar Kosovën si destinacion turistik. Ndër të tjera, gjatë këtij viti kemi filluar edhe krijimin e infrastrukturës ligjore si një bazë për zgjerimin e ofertës turistike dhe sigurinë e turistëve si dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre", ka thënë ministrja Krasniqi.

Ajo ka treguar edhe për nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit me Agjencinë Japoneze të Turizmit në kuadër të shkëmbimit të përvojave me vendet mike. "Vëmendje të veçantë po i kushtojmë zhvillimit të marrëdhënieve të mira me vendet mike në mënyrë që Kosova të jetë një vend i veçantë i turizmit. Së fundmi, kemi nënshkruar memorandum bashkëpunimi në fushën e turizmit me Agjencinë Japoneze të Turizmit, ku synohet shkëmbimi



i dyanshëm i informatave, përvojave dhe njohurive në fushën e turizmit përmes rritjes së

numrit të turistëve ndërmjet dy vendeve", ka thënë Krasniqi. Iniciativat e reja të MTI-së për

zhvillimin e turizmit të Kosovës do të ndikojnë që Kosova të jetë vend i rëndësishëm turistik.

Modernizimi i sistemit të ujitjes, një nga prioritetet e NH "Ibër-Lepenci"

PRISHTINË, 27 SHTATOR (ER) - Zëvendësministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Mevludin Krasniqi, është takuar me kryeshefin ekzekutiv të Ndërmarrjes Hidroekonomike "Ibër-Lepenci", Berat Lushtaku, me të cilin ka diskutuar për rëndësinë e sistemit të ujitjes së kësaj ndërmarrje për sektorin e bujqësisë.

Zëvendësministri Krasniqi ka

thënë se investimet dhe modernizimi i sistemit të ujitjes është një nga prioritetet e NH "Ibër-Lepenci" dhe e ka mbështetjen e plotë të institucioneve të Kosovës. "Në një takim pune me kryeshefin ekzekutiv të NH 'Ibër-Lepenci', z. Berat Lushtaku, e përgëzova për punën e deritashme dhe biseduam për rëndësinë e sistemit të ujitjes së kësaj ndërmarrje për sektorin e bujqësisë. Investimet dhe

modernizimi i këtij sistemi është një nga prioritetet e NH 'Ibër-Lepenci' dhe e ka mbështetjen e plotë të institucioneve të Kosovës. Tash dhe vitet në vijim bashkëpunimi ynë do të jetë në funksion të angazhimeve tona të përbashkëta, me qëllimin e vetëm: mbështetjen e fermerëve dhe zhvillimin e bujqësisë", ka deklaruar zëvendësministri Krasniqi.



Zhvillimi i infrastrukturës rrugore ndikon te bizneset



EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Me qëllim të informimit të bizneseve me zhvillimet e fundit të Ministrisë së Infrastrukturës në Kosovë, planet e ardhshme si dhe ndikimin që ato kanë në aktivitetin biznesor, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar të enjten një tryezë diskutimi me ministrin e Infrastrukturës, Pal Lekaj.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka thënë se Ministria e Infrastrukturës është një ministri e rëndësishme për sa i përket operimit të bizneseve, duke shtuar se vitet e fundit janë bërë investime të shumta që përmirësojnë infrastrukturën transportuese në vend. Ndërkaq ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka njoftuar të pranishmit lidhur me zhvillimet e fundit të ministrisë që ai

drejton për përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës transportuese rrugore, hekurudhore dhe ajrore.

Ministri Lekaj ka pohuar se është duke u punuar shumë për adresimin e sfidave dhe problemeve që bizneset hasin për sa i përket infrastrukturës, duke përmendur edhe mirëmbajtjen e rrugëve. Ai ka folur për përfitimet për qytetarët dhe bizneset nga autostrada me Shqipërinë, si dhe përfundimin e

shpejtë të autostradës në drejtim të Maqedonisë, por edhe autostradat e tjera në të cilat ministria që ai drejton është duke investuar për momentin, si ajo e Gjilanit dhe Dukagjinit. Po ashtu, ministri Lekaj ka folur për investimin e Ministrisë për zgjerimin e pistës së Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, i cili do ta mundësojë operimin e fluturimeve edhe në kushte më të rënduara atmosferike, ndërsa ka theksuar se fokusi

i Ministrisë do të jetë në shtimin e masave të sigurisë në infrastrukturën rrugore.

Duke falënderuar Odën Amerikane për organizimin e diskutimit, ai u shpreh se dialogu i drejtpërdrejtë ndërmjet ministrisë dhe bizneset mundëson marrjen e rekomandimeve nga ana e tyre, duke ndihmuar kështu ministrinë për përmirësimin e legjislacionit dhe implementimin më të mirë të ligjeve ekzistuese.

Investitorët gjermanë interesohen për sektorin e energjisë dhe të minierave në Kosovë

PRISHTINË, 27 SHTATOR (ER) - Ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka pritur të enjten në takim një delegacion të investitorëve gjermanë, të cilët i ka njoftuar për procedurat e aplikimit për t'u kualifikuar si investitor strategjik. Ai ka biseduar edhe për punën që Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike është duke bërë për krijimin e kushteve për ta. Delegacioni i investitorëve gjermanë, që përbëhej nga Daniel Dauber, Urve Dietz, Frank Wisel, Gabriele Bitter dhe Ismail Yilmaz, kanë shprehur interesim për sektorët e minierave dhe të energjisë së ripërtërishme, duke dëshiruar ta ndjekin edhe shembullin e Bitterit, e cila tash-

më ka bërë një investim në kompani për prodhimin e ngjyrave.

Ministri Gashi e ka vlerësuar lart rolin dhe interesimin e kompanive gjermane, ndërsa këta të fundit, duke falënderuar ministrin për pritjen, kanë shprehur gatishmëri për t'i zgjeruar investimet e tyre në Kosovë edhe në sektorët e tjerë, duke u kualifikuar kështu si investitorë strategjikë. Delegacioni gjerman ka vlerësuar procesin e investimeve strategjike si një formë më e lehtë dhe atraktive për investitorë seriozë. Ky delegacion ka ardhur për vizitë në Kosovë me iniciativë të Bekim Brestovcit, drejtor i Unionit të Bizneseve Shqiptare në Gjermani.



Ngrihet aktakuzë ndaj Pjetër Nrecajt për vrasjen e gruas dhe vajzës

GJAKOVË, 27 SHTATOR (ER) - Prokuroria Themelore në Gjakovë ka ngrehur aktakuzë kundër të akuzuarit Pjetër Nrecajt për shkak të veprës penale vrasje e rëndë si dhe për veprën tjetër mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve. "Prokuroria Themelore Gjakovë ka ngrehur aktakuzë kundër të akuzuarit P.N. për shkak të veprës penale 'vrasje e rëndë' nga neni 179, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, 1.3 dhe 1.11 i KPRK-së, dhe për veprën penale 'mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve' nga neni 374, paragrafi 1 i KPRK-së", është bërë me dije në njoftimin e Prokurorisë Themelore në Gjakovë.

Sipas aktakuzës së Prokurorisë, i

akuzuari P. N., më 7. 8. 2018, në Gjakovë, në shtëpinë e familjes së viktimës, me dashje ka privuar nga jeta bashkëshorten V. N. dhe vajzën K. N. "I akuzuari P. N. ka shkuar në shtëpinë e vëllezërve të viktimës i armatosur, ku ka qëlluar me pushkën automatike në drejtim të shtëpisë, si dhe, ka qëlluar me armë bashkëshorten dhe vajzën e vet. Të njëjtat nga plagët e marra kanë ndërruar jetë. I akuzuari P. N. akuzohet për dy vepra penale 'vrasje e rëndë', nga neni 179, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, 1.3 dhe 1.11 i KPRK-së, dhe për veprën penale 'mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve' nga neni 374, paragrafi 1 i KPRK-së", është theksuar në komunikatën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë.



Rastet e dhunës në familje të trajtohen me prioritet

PRIZREN, 27 SHTATOR (ER) - Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Admir Shala, ka mbajtur takim me të gjithë përgjegjësit të cilët merren me trajtimin e rasteve që ndërlidhen me veprat penale të cilësuar si dhunë në familje, brenda kompetencës së kësaj prokurorie, me qëllim të ngritjes së efikasitetit për trajtimin e rasteve të tilla. Në këtë takim ishin të pranishëm prokurorë përgjegjës për rastet e dhunës në familje, përfaqësues nga Policia e Kosovës për rajonin e Prizrenit, gjykatës, mbrojtës të viktimave, përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale, Strehimorja, Zyra për Ndihmë

Juridike Falas si dhe zyrtarë nga Shërbimi Sprovues.

Gjatë takimit, kryeprokurori Shala nga të pranishmit kërkoi bashkëpunim dhe bashkërendim të plotë mes institucioneve kompetente, me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme, që trajtimi i rasteve të tilla të ketë prioritet të plotë dhe ndaj tyre të veprohet dhe të reagohet me urgjencë.

Pjesëmarrësit në takim u pajtuan për nevojën e ndërtimit të raporteve më të drejtpërdrejta edhe me viktimën (të dëmtuarën) e dhunës në familje. Në këtë drejtim koordinatori për dhunë në familje nga

Prokuroria Themelore në Prizren, Mehreme Hoxha, zyrtarëve policorë ua prezantoi nga një kopje të vlerësimit të rrezikut si dhe të urdhrin për mbrojtje emergjente, me rekomandimin që në të ardhmen së bashku me kallëzimin penal, të plotësohet nga viktimata edhe formulari për vlerësimin e rrezikut.

Në fund të takimit, të gjithë pjesëmarrësit vlerësuan se duhet të thellohet edhe më tutje bashkëpunimi dhe të mbahen takime më të shpeshta sa iu përket rasteve të tilla në mënyrë që të shtohen mekanizmat e mbrojtjes ndaj dhunës në familje.



Nënshkruhet marrëveshja për hapjen e puseve për ujë të pijshëm

MALISHEVË, 27 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe kryeshefi ekzekutiv i Hidroregjionit Jugor, Besim Baraliu, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëfinansimi për "hapjen e puseve piezometër dhe puseve eksploatuese" në fshatrat Temeqinë, Bellanicë, Llapqevë

dhe fshatrave të tjera sipas nevojave në këtë komunë. Kjo marrëveshje është nënshkruar me qëllim të hapjes së këtyre puseve, pasi nevoja për ujë të pijes është e madhe, sikur edhe shtimi i kapaciteteve të ujit, sasisë dhe kualitetit të ujit, dhe zgjerimi i rrjetit të ujit në fshatrat ku nuk ka rrjet të ujësjellësit. Sigurimi i ujit për pije për

të gjitha vendbanimet e Komunës së Malishevës është prej prioriteteve të veçanta dhe për këtë qëllim, kryetari i kësaj komune, Ragip Begaj, është duke bërë përpjekje që përmes projekteve të ndryshme ta zgjerojë rrjetin e ujësjellësve në mënyrë që fshatrat e Komunës së Malishevës të jenë të furnizuar me ujë.

Komuna e Prishtinës zbaton sistemin 'One Stop Shop' në urbanizëm

PRISHTINË, 27 SHTATOR (ER) - Është mbajtur takimi i tretë i Kolegjiumit të Planifikimit Hapësinor të drejtorëve komunalë të urbanizimit dhe planifikimit hapësinor në Prishtinë. Në këtë takim u diskutua për sistemin "One Stop Shop", që del si obligim për secilën komunë nga Udhëzimi Administrativ 06/2017 i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Komuna e Prishtinës përmes një komunikatë për medie ka bërë me dije se është e vetmja që ka këtë sistem funksional. "Mbi 70 për qind të aplikimeve aktualisht bëhen përmes këtij sistemi. Gjithashtu, Prishtina është komuna e vetme që e aplikon sistemin 'Permit Tracking

Sistem' përmes të cilit u mundësohet qytetarëve vëzhgimi i procesit të lëndës gjatë procedurave të shqyrtimit në Drejtorinë për Urbanizëm, Ndërtim dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUNMM). Kësisoj, DUNMM e Komunës së Prishtinës ka mbajtur prezantimin për sistemin 'One Stop Shop' para drejtorive të komunave të tjera, me ç'rast i ka informuar ato për mënyrën e krijimit, organizimit dhe funksionimit të këtij sistemi", është theksuar në komunikatën e Komunës së Prishtinës.

"One Stop Shop" është hapi i parë i digitalizimit dhe thjeshtimit të procedurave për pajisje me kushte ndërtimore dhe leje të ndërtimit.



Kosova synon të arrijë marrëveshje në Ballkan



Shkruan:
Hashim THAÇI

Këtë vit Kosova festoi 10-vjetorin e pavarësisë së vet. Është kohë e përshtatshme për festë dhe reflektim për popullin tonë dhe aleatët tanë. Kosova është një demokraci e re, e qëndrueshme dhe e begatë, që synon të bashkohet me BE-në dhe NATO-n si shumica e fqinjëve dhe partnerëve të saj. Por, rruga përpara është e gjatë dhe e mbushur me pengesa.

Ne besojmë se Kosova është treguar partnere e besueshme ndaj BE-së. Ne i ndajmë të njëjtat qëllime. Jemi angazhuar në mënyrë aktive në dialog me Serbinë, një proces që unë jam krenar që e udhëheq për shumë vite. Atyre që u kujtohen luftërat e tmerrshme të viteve 1990, do

ta kuptojnë rëndësinë e kësaj përpjekjeje. Kosova ka qëllime dhe pritshmëri të qarta nga përpjekjet tona për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Dialogu duhet ta çojë Kosovën dhe Serbinë drejt njohjes formale të ndërsjellë dhe marrëdhënieve të plota diplomatike me njëra-tjetrën. Kosova duhet të ketë një rrugë të qartë, të barabartë dhe të papenguar të anëtarësimit në BE, NATO dhe OKB.

Kosova do ta ruajë sistemin e tanishëm politik si një republikë unitare. Ajo është efektive në integrimin e të gjitha komuniteteve dhe siguron se ata mund të udhëheqin jetën e tyre të përditshme. Ne nuk do të shqyrtojmë eksperimente që do të bënin rrëmujë nga rendi kushtetues.

Deri sa Kosova dhe Serbia të zgjidhin dallimet e tyre, ne nuk do të jemi në gjendje t'i bashkohemi BE-së. Kjo është arsyeja pse është kaq e rëndësishme për mua që të arrijmë një traktat ligjor të detyrueshëm të paqes me Serbinë. Njerëzit e Kosovës do të kenë një të ardhme më të

ndritur dhe më të mirë si pjesë e familjes së madhe euroatlantike.

Për Kosovën nuk ka alternativë ndaj anëtarësimit në BE dhe NATO. Ne nuk kemi një Plan B, as nuk jemi duke e kërkuar një të tillë. Dritarja e mundësisë për të arritur marrëveshje me Kosovës dhe Serbisë është e hapur, por ajo është duke u zvogëluar. Potenciali për të tjerët për të përfituar nga vakumi dhe paqartësitë është i madh. Për këtë arsye unë jam angazhuar sërish me presidentin serb, Aleksandar Vuçiq, për të kërkuar në mënyrë aktive zgjidhje kreative që do të sjellin një marrëveshje të drejtë dhe përfundimtare. Ne kemi nevojë për një zgjidhje të qëndrueshme që mbulon dy dallimet aktuale dhe pikat potenciale të konfliktit të ardhshëm. Ne nuk do të pranojmë marrëveshjet e përkohshme apo vazhdimin e status quo-s.

Një çështje tensioni mbetet kufiri midis dy vendeve tona. Është shkruar shumë për këtë javëve të fundit. Disa prej tyre edhe gjëra të panevojshme nxitëse. Dëshiroj të qartësoj

këtu diçka. Historia e Ballkanit nuk është ajo e marrëveshjeve, por e mosmarrëveshjeve. Ne kemi një shans për të ndryshuar këtë kurs.

Ashtu siç i kemi vendosur kufijtë tanë me Maqedoninë dhe Malin e Zi, çdo marrëveshje përfundimtare me Serbinë do të duhet të adresojë kufijtë tanë shtetërorë. Duke vepruar kështu, ne besojmë se çdo korrigjim kufitar duhet të bazohet në parimet e forta të ligjeve ndërkombëtare dhe vlerave tona të përbashkëta.

Së pari dhe më kryesorja, një korrigjim kufitar nuk duhet të bazohet në parimin e ndarjes etnike. Ne nuk duam të ndajmë dy popujt tanë. Është e panevojshme të thuhet se çdo marrëveshje përfundimtare duhet të shoqërohet me garanci të forta për mbrojtjen e vazhdueshme të të drejtave të të gjitha komuniteteve që mbeten në vendet tona përkatëse, duke përfshirë ruajtjen e monumenteve fetare.

Së dyti, ne nuk po kërkojmë të krijojmë kushtet për ndryshimin e kufijve kudo në rajon, si shembull me

Shqipërinë, pavarësisht asaj që disa thonë. Kosova kurrë nuk ka qenë precedent. Ajo do të mbetet si një rast Sui Generis. Kosova dhe Serbia janë shtete sovraane. Ligji ndërkombëtar i lejon shtetet sovraane të përcaktojnë kufijtë e tyre, siç ato e shohin të arsyeshme, dhe vendimet tona nuk kanë asnjë ndikim ndaj ndonjë shteti tjetër.

Aktualisht, tensioni mes Kosovës dhe Serbisë mbetet i lartë. Historia e BE-së tashmë ka treguar se kufijtë e rënë dakord së bashku me një vizion të përbashkët të një të ardhmeje paqësore dhe bashkëpunuese mund t'i bëjnë kufijtë shtetërorë më pak të rëndësishëm. Ne duam që ky model të funksionoj edhe për ne. Një kufi i pranuar reciprokisht, si pjesë e një marrëveshjeje më të gjerë përfundimtare, do t'i lejojë Kosovës dhe Serbisë të hedhin themelet për një marrëdhënie më të hapur dhe një të ardhme më paqësore.

(Ky editorial i presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, është botuar në "Financial Times")

Kosova, ky shtet yni, është në rrezikun më të madh pas shpalljes së pavarësisë



Isa MUSTAFA

Idetë për korrigjim të kufijve, për shkëmbim të territoreve, për autonomi speciale për serbët, janë kanosje serioze ndaj asaj çfarë kemi ndërtuar këta dhjetë vjet, që nga Deklarata e shpalljes së Pavarësisë, aprovim i Kushtetutës e vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Nuk ka asnjë arsye që Kosova pas 116 njohjeve ta vë në pikëpyetje shtetësinë e vet, thjesht nga fakti se këtë shtetësi

nuk e ka pranuar Serbia, se po u dashka të krijojë hapësirë që edhe Serbia të fitojë diçka. Serbia shkaktoi mbi 13 500 viktima të luftës në Kosovë, hordhitë serbe dhunuan mbi 20 mijë gra, shkatërruan mbi 100 mijë prona, plaçkitën fondin e pensioneve, dezinvestuan në të gjitha fushat, shkatërruan ekonominë, depërtuan mbi një milion banorë... Këto janë viktimat dhe disa nga pasojat e shkaktuara nga logjika e Serbisë për të fituar. Prandaj, nuk duhet të krijojmë rast për viktima të tjera, për zhvendosje të popullsisë e për konflikte të reja.

Korrigjimi i kufijve dhe shkëmbimi i territorit nuk e përfundon raportin me Serbinë, por e thellon amullinë e shtetit të Kosovës. Serbët nuk jetojnë vetëm në veri, ata jetojnë edhe në gjashtë komuna me shu-

micë në brendi të Kosovës, jetojnë në Bujanoc dhe Medvegjë (që po thuhet se i marrim bashkë me Preshevën pa dhënë asgjë!?) prandaj çështja e serbëve nuk përfundon me kufij etnikë, por fillon me rrëmbim të një pjese të territorit, pastaj me kërkesa specifika për Kishën Ortodokse serbe dhe për komunat me shumicë serbe. Fillon e nuk mbaron. Idetë e tilla e shkatërojnë qenien tonë shtetërore dhe na sjellin në një gjendje të padefinuar.

Arsyetimi i korrigjimit të territorit me "zbulimet" se komunat në veri i kemi marrë si dhuratë nga Tito dhe Rankoviçiq për ta prishur përbërjen etnike të Kosovës është joserioz, për aq sa do të ishte joserioze të mendohet se ne paskemi gabuar që e kemi shpallur pavarësinë në territorin që përfshinë edhe

këto komuna të veriut, në tokën e Kosovës. Kjo sjellje është mohim i Deklaratës së Pavarësisë nga goja e institucionit formalisht më të lartë të vendit.

Idetë dhe iniciativat për ta dërmuar këtë vend nuk janë të pakta. Sa isha kryeministër i Kosovës me pompozitet trumbetohej iniciativa për Unionin Ekonomik të Ballkanit Perëndimor. Një Jugosllavi e re, pa Kroacinë e Slloveninë, por me Shqipërinë. Sikurse edhe ideja për Unionin Doganor të Vendeve të Ballkanit Perëndimor. Unë i kam kundërshtuar fuqimisht në emër të Qeverisë së Kosovës dhe nuk kemi lejuar që Kosova të shkrihet në organizma të tillë që në substancë e dëmtonin shtetin tonë.

Si Lidhje Demokratike e Kosovës konsiderojmë se

Kosova i ka kufijtë e vet të merituar dhe legjitimë, se prekja e kufijve është prekje dhe cenim i genies sonë shtetërore. Serbia duhet ta pranojë Kosovën në kufijtë që e ka shpallur pavarësinë dhe në të cilët e kanë njohur mbi gjysma e shteteve të rruzullit tokësor. Normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë nuk duhet ta blejmë me shkëmbime territore, por duhet ta arrijmë me ndërtim të raporteve të paqes dhe fqinjësisë së mirë dhe respektim të të drejtave të serbëve sipas standardeve më të mira evropiane, me zhvillim ekonomik dhe prosperitet arsimor e kulturor. Pozita e pakicave, as atyre shqiptare dhe as atyre serbe, sikurse edhe e pakicave të tjera, nuk zgjidhet me kufi etnikë dhe me zhvendosje të tyre, por duke ua siguruar të drejtat e barabarta.

Erdogani në Gjermani, blindohet Berlina

BERLIN, 27 SHTATOR - Berlina është blinduar të enjten nga forcat e sigurisë në "Tegel Airport", ku presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan ndodhet për një vizitë delikate shtetërore, transmetojnë autoritetet gjermane. Pas një konflikti me Gjermaninë që ka alarmuar diplomacinë në vitet e fundit dhe ku udhëheqësi turk arriti ta akuzonte qeverinë Merkel për metoda naziste dhe nuk ka kërkuar falje për këtë, Erdogan kërkon që me misionin

e sotëm të afrohet jo vetëm me Gjermaninë, por edhe me Evropën.

Vizita e tij vjen në kohën kur problemet ekonomike në Turqi po shkaktojnë shqetësime në rritje dhe kur Evropa ka nevojë për mbështetjen e Ankarasë në reduktimin e rrjedhës së emigrantëve. Kjo është vizita e parë zyrtare e Erdoganit në Gjermani, ku spektri politik e sheh me dyshime.

Në mars të vitit të kaluar,

Erdogani i ka krahasuar zyrtarët gjermanë me nazistët. Ai i ka bërë këto komente pasi autoritetet gjermane i kanë anuluar tubimet që ai ka planifikuar t'i mbajë për diasporën turke në Gjermani, në prag të një referendumit të rëndësishëm për pushtetin e tij.

Në një shkrim të publikuar të enjten në gazetën "FAZ", Erdogan ka thënë se "është koha të lihen mënjane dallimet në opinione dhe përqendrimi të jetë mbi interesat e përbashkët".



Trumpi: Denuklearizimi i Koresë Veriore nuk do të bëhet me nxitim

Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, në lidhje me denuklearizimin e Koresë së Veriut, tha se do të bëjmë diçka që do të jetë shumë e rëndësishme, por kjo do të marrë kohë

NJU JORK, 27 SHTATOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha se nuk ka afat kohor për denuklearizimin e Koresë së Veriut, edhe pse më herët ka kërkuar që shteti komunist t'i dorëzojë armët bërthamore sa më parë që të jetë e mundur. "Mendoj se do të bëjmë diçka që do të jetë shumë e rëndësishme, por nuk do të bëjmë lojë me kohën", tha Trumpi në një konferencë me gazetarë në Nju Jork. "Nëse merr dy vjet, tre vjet ose pesë muaj, kjo nuk ka rëndësi", tha presidenti amerikan.

Komentet e tij vijnë pasi sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, zhvilloi një takim me ministrin e Jashtëm verikorean, të cilin e cilësoi shumë pozitiv. Pompeo do ta vizitojë sërish Phenjanin muajin e ardhshëm, për ta përgatitur takimin e dytë të Trumpit me udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jong Un.

Trumpi dhe Kim janë takuar për herë të parë më 12 qershor në Singapor. Atëbotë Kimi është zotuar se do të punojë

drejt denuklearizimit të Gadishullit Korean.

Angazhimet dhe veprimet e Kimi, megjithatë, nuk i kanë plotësuar kërkesat e Uashingtonit për ta bërë listën e plotë të armëve që ka dhe për të bërë hapa të paktheshëm për dorëzimin e arsenalit bërthamor që mund t'i kërcënojë Shtetet e Bashkuara. Trumpi zbuloi se ka marrë një letër "të jashtëzakonshme" nga Kimi dhe tha se do të takohet më të së shpejti. Trumpi e cilësoi letrën si "copëz të bukur arti", por nuk tha se çfarë është shkruar në të. "Shtetet e Bashkuara dhe Koreja e Veriut po zhvillojnë marrëdhënie të mrekullueshme. Kimi dëshiron marrëveshje. Unë dua marrëveshje. Ai më pëlqen mua, unë e pëlqej atë", tha Trumpi. Ai po ashtu tha pa paraqitur prova se paraardhësi i tij, Barack Obama, ka qenë gati të shkojë në luftë me Korenë e Veriut në javët e fundit të presidencës, porse zgjedhja e tij "e ka shpëtuar botën nga "gjëma". "Po të mos zgjidhesha unë, ju do të shkonit në luftë.



Ai ka qenë gati të shkojë në luftë. Ju do të kishit luftë dhe do të humbnit miliona, jo mijëra", tha Trumpi.

Është raportuar se Obama e ka paralajmëruar Trumpin gjatë tranzicionit presidencial se

Koreja e Veriut paraqet kërcënim serioz, por kriza është përkeqësuar në vitin e parë të administratës Trump, kur Phenjani ka testuar një bombë termonukleare dhe disa raketa balistike ndërkontinentale.

Vitin e kaluar, në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Trumpi e ka kërcënuar Korenë e Veriut me "shkatërrim total", ndërsa Kimin e ka quajtur "njeri të raketave".

Poroshenko kërkon ndalimin e agresionit rus në Ukrainë

NJU JORK, 27 SHTATOR - Presidenti ukrainas Petro Poroshenko u ka bërë thirrje shteteve të ndihmojnë në ndalimin e agresionit rus në shtetin e tij, duke thënë se luftimi i një ndërhyrjeje të tillë është pjesë e misionit të Kombeve të Bashkuara. Poroshenko ka shfrytëzuar pjesën më të madhe të fjalimit të tij në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së për ta sulmuar Rusinë, e cila ka aneksuar Gadishullin e Krimesë më 2014 dhe që nga ajo kohë ka mbështetur separatistët në konfliktin në lindje të Ukrainës, çka ka

rezultuar me më shumë se 10 300 persona të vdekur.

Poroshenko ka thënë se asgjë nuk do të ndalojë atë që e ka cilësuar si "politikë agresive imperialiste" të Rusisë, përveç nëse kombet e botës bashkohen për t'u përballur me liderët e Moskës. "Është në dorën tonë t'i mbikëqyrim ata. Përndryshe, cila është ideja e të mbledhurit këtu?", ka pyetur ai. Rusia nuk ka komentuar fjalimin e Poroshenkos, derisa Kremli vazhdimisht mohon ndonjë përfshirje në konfliktin në lindje të Ukrainës.

Në një forum të ndarë të OKB-së, agjencia ruse e lajmeve "Interfax" ka raportuar se Poroshenko ka përsëritur thirrjet e tij për një operacion paqeruajtës të OKB-së në Ukrainë, duke thënë se një gjë e tillë do të ndihmonte në rikthimin e sovranitetit dhe integritetit territorial.

Poroshenko ka falënderuar Gjermaninë, Francën dhe Shtetet e Bashkuara për mbështetjen ndërkombëtare për këtë iniciativë, ndonëse OKB-ja nuk ka miratuar asnjëherë kërkesën për mision paqeruajtës.




NGA MONOGRAFIA PËR MASAKRËN E DELIAJVE TË ABRISË SË EPËRME

Afrim HYSENAJ

Veprimtaria shkrimore nuk është as vokacion dhe as profesion imi, por është një shtysë më e madhe e brendshme që nuk më ka lënë, nuk më la e nuk më le të qetë pa hedhur në letër mbresat dhe kujtimet. Një shtysë e dytë, ende më e madhe, m'u bë barra e ndërgjegjes dhe borxhi ndaj atyre që qenë pjesëtarë të kësaj ngjarjeje, të vranë a të mbijetuar. Tashiti po bëhen dy dekada. Dy dekada nuk janë pak. Po e morën të mirëqenë mesataren e rrojtjes së njeriut prej shtatëdhjetë deri tetëdhjetë vjet del një e katërta e saj. Brezi i sotëm i njëzetvjeçarëve dhe, ende më shumë, nuk di sa e si duhet për këtë tragjedi. Nuk ka një paraqitje më të plotë e më shtruese të saj, as në rrafshin shkrimor dhe as në planin dokumentar (konferenca a simpoziume a aspekte të tjera shkencore-hulumtuese për të). Ja edhe një shtysë e tretë motivuese për t'i hedhur në letër dritëhijet e saj. Në shënimet e mia për këtë monografi ka gjetur vend kujtesa, imja dhe e dëshmitarëve, kronikat e kohës, burimet e mediave elektronike e të shkruara, analet e portaleve, rrjeteve sociale dhe të internetit. Pavarësisht prej faktit se kam qenë edhe vetë pjesëmarrës aktiv në veprimet dhe rrjedhat e të ndodhurave të atëkohshme jam përpjekur që ta disiplinohj botën emocionale, të mos cenohj vërtetësinë dhe objektivitetin. Kam respektuar me ngulm parimet themelore shkencore rreth mbledhjes së materialeve, sistemit të tyre, mbarështimit

dhe strukturimit të lëndës, por pa u bërë rob i formave të ngurta didaskalike e metodike. Krahas boshtit tematik monografik, i kam dhënë vetes dorë të lirë edhe në paraqitjen panoramike të kohës dhe vendit të ngjarjes. Një tundim më vete më ka dhënë përzgjedhja e titullit të këtij libri. Është e padyshimtë se ngjarja s'është veçse një tragjedi përmasash të mëdha me shifra, po akoma më e madhe me dramën e brendshme të shpirtit të njerëz-orë. Kështu, nocionet masakër, ployjë, kërdi më rrihnin si çekan në ndërgjegje. Sa doja t'i shmangia më shfaqeshin prapë. I lexoja e rilexoja ngeshëm shpjegimet në Fjalorin e Gjuhës Shqipe: "MASAKËR f. Vrasje e therje e njerëzve të pambrorjtur në masë dhe në mënyrë mizore; shfarosje në masë; kasaphanë, kërdi, mizori...; PLOYJË f. bised. Gjakderdhje, kërdi...; KËRDI f. Vrasje a vdekje në masë, gjakderdhje; shkatërrim a dëm i madh; fatkeqësi e madhe; shfarosje...". Të gjitha qëndronin, varësisht nga nuancat e veçantitë kuptimore po, megjithatë, ma jepnin një qark të mbyllur të mizorisë që kishte ndodhur. Kështu zgjodha një titull përshkrues që i rri për shtat atmosferës dhe tensionit të kohës e të hapësirës, "Toka skuq e qielli nxin", me dedikimin në nëntitull: Monografi për masakrën e Deliajve të Abrisë së Epërme. Kujtesa jonë historike ka shumë hone dhe mungesa dokumentesh e burimesh. Tragjeditë tona kombëtare pothuajse asnjëherë nuk i njohu bota plotësisht, në përmasën e tyre reale. Këto tragjedi, për fatin tonë të keq, shpesh u



dhanë e u pasqyruan si gjysmë të vërteta. Të vërtetës së hidhur e fatkeqe të luftës së fundit, të luftës për çlirim-in e Kosovës, ky studim monografik synon t'i japë një kuadër më të plotë dukshmërie mbështetur në dëshmi faktesh, dokumentesh dhe të dhënash të tjera, duke zbatuar metodën e intervistimit e të bashkëbisedimit edhe me dëshmitarë të mbijetuar. Përmasa e saj tragjike, dhe sidomos jehona në planin e brendshëm dhe ndërkombehtar jo vetëm tronditën mendjet e njerëzimit, por edhe u bënë ndikim me peshë në rrjedhat e pastajme të luftës për çlirim të Kosovës. Është e çuditshme se si edhe pas, pothuajse dy dekadave, kujtesa e njerëzve dëshmitarë dhe e atyre që e mbijetuan masakrën ka arkivuar me aq besnikëri pamje e përjetime, thua se koha ka ngrirë në shkallën zero. Kjo provohet edhe me ngjashmëritë e përmbajtjeve dhe të shifrave e detajeve

pothuajse në narrativën e secilit. Krahas rrëfimeve të tyre këtu kam sjellë edhe dëshmitë nga këndi tjetër, nga gazetarë e diplomatë të jashtëm; kam sjellë reagimet e tyre dhe pasqyrimin që i kanë bërë kësaj ngjarjeje në mediat përkatëse anembanë botës. Është fakt i pakontestueshëm se masakra e Abrisë së Epërme ka tundur e shkundur ndërgjegjen e njerëzimit dhe kjo provohet me fakte në kapitullin që flet për jehonën dhe ndikimin e saj në politikën dhe diplomacinë botërore. Këtu nuk ka asnjë teprim po të thuhet se kjo ngjarje, në kuptimin më të plotë të fjalës, shënon kthesë në historinë bashkëkohore të Kosovës, përkatësisht në historinë totale të kombit shqiptar. Këtu nuk dua të flas tani për mundin dhe vështirësitë, sepse ato i përballova falë gatishmërisë dhe ndihmës së pakursyer të të gjithë atyre miqve e dashamirësve që m'u gjetën pranë;

bashkëpunëtorëve e bashkëbiseduesve që me kurajë më mbushën shpirtërisht me rrëfimet e tyre pa kursyer kohën e çmuar. Ndaj s'kam si t'i kursej falënderimet për familjarët e Deliajve dhe miqtë e tyre. Vend nderi rezervoj sidomos për heroin tim, Imer Deliu. Atë bashkë me redaktorin, Adem Gashin, i pata dorë të dhathtë që t'i dilja mbanë këtij libri.

Falënderoj të gjithë rrëfyesit, gra dhe burra të fshatit tim e të fshatrave përreth, të cilët në ditët e kobshme qenë të pranishëm në Lagjen Deliu. Po ashtu, dua t'i falënderoj edhe dy recensentët që, me insistimin tim dhe vullnetin e tyre, u bënë pjesë e këtij libri. S'do mend, s'mund t'i mbetem borxh përkthyeses së vyer të gjuhës angleze, Besarta Hamdi Demaku. Ajo mbi baza krejt të vullnetshme nuk kurseu mundin e saj në punë të shqipërimin të teksteve. Falënderoj sinqerisht bashkëfshatarin dhe bashkëluftëtarin tim, z. Fadil H. Demaku, për bashkëpunim e ndihmë të pakursyer! E ruaj për fund falënderimin e përzemërt edhe për prindërit, bashkëshorten, fëmijët, motrën time dhe vëllezërit, të cilët më kanë mbështetur moralisht, ekonomikisht dhe, para së gjithash, me kohën e konsideratën që më kanë kushtuar. Jo, jo. Pa këta njerëz nuk do të bëhej gjë, aq më pak ky libër që e kisha peng të shpirtit tim.

(Nga libri "Toka skuq e qielli nxin: monografi për masakrën e Deliajve të Abrisë së Epërme")

FËMIJA I PALINDUR

Adem GASHI

Një monografi për një ngjarje shumë të njohur nga një autor "i panjohur". E, megjithatë, ne nuk i prekim kufijtë e njohjes, kufijtë e të dukshmes dhe të të padukshmes. Pikiata e hulumtimit të Afrim Hysenajt lëshon spirancën këtu e dy dekada më parë, pikërisht në Abri të Epërme, ku kishte ndodhur hataja, masakra e familjes Deliaj nga forcat serbe. Jehona e kësaj ngjarjeje, nga një fshat i vogël, kishte përthekuar globin. Duke e lexuar sot këtë monografi ne bindemi se nuk dinim asgjë më shumë se një maje ajsbergu dhe ritmi i kohës, si një det veriu, mbulonte edhe më shumë me vellon e tij të akullit një vullkan që ziente përbrenda. Hysenaj, duke qenë një nga dëshmitarët e parë të kësaj masakre, sikur i thotë vetes: lëviz ti një çikë mekanizmin e lëri të tjerët të

flasin. Në këtë plan më vjen goxha i çuditshëm qëndrimi i tij dhe forca për ta disiplinuar vetveten, për ta ruajtur distancën emocionale, për ta fjetur subjektivizmin deri në shkallën e një vrojtuesi asnjëherë. Sikur thotë, "unë po bëj vetëm regjistruuesin e rrëfimeve tuaja". Kjo është ajo që njihet si disiplinë shkencore e një shkalle të admirueshme, aq më tepër, kur në planin e kulturës shkrimore, ai vjen me një përvojë shumë modeste. Dikush nga cinikët mund të thotë, "po ç'iu desh kjo atij!", dhe ai, prapë me modesti olimpikë, mund t'ua kthejë: "Ju ndaloi njeri ta bënit ju?" Gjëra të arkivuara autori ka ruajtur tash e dy dekada, po ngulmimin hulumtues me përqendrim e bën tash e një vit. Në plan të strukturës ai ka vizatuar një kornizë sinopsi prej shtatë kapitujsh, duke e nxjerrë në plan të parë MEMO-n, ku shpalon fabulën e tragjedisë tuaja në mënyrë telegrafike. Pastaj

me rëndon një për një dëshmitë e drejtpërdrejta të atyre që e mbijetuan tragjedinë, të atyre që qenë ndër të parët që e panë, të atyre që bënë varrimin, të atyre që u dhanë zë edhe zërave të të vranëve. Në aspektin tipologjik, monografia "Toka skuq e qielli nxin" tejkalon modelin panoramik dhe metodikën teorike shkollore, duke i dhënë dorë ndërtimit në formë mozaiku, ku pleksën lirshëm fakti, arti, jeta. Dëshmitë gojore të bashkëfolësve Hysenaj na i sjell me tërë autenticitetin, pa prekur e ndërhyrë në strukturën gjuhësore sintaktike, pa retushuar e korrigjatur shprehjet, frazat e konstruktet sa dialektore, po aq edhe kraharizmas; sa gjysmëstandarde, po aq edhe standarde. Një punë me durim e vullnet të skajshëm. Ndoshta këtu që e rendit të shtroja për diskutim, që në krye të herës, titullin e monografisë. Përse nuk e bëri thjesht "Masakra e

Abrisë së Epërme"? Ndoshta nga mëtimi për ta thyer klisenë, skemën! Ndoshta nga përkushtimi për ta ngjyrosur skenën e atyre ditëve e netëve, kur të strehuarit nëpër tenda maleve s'shihnin tjetër veçse granata, predha, plumba që skuqnin tokën, në një qiell të brustë e të nxirë! Përtej punës-detyrë prej redaktori, me Afrimin kemi ndenjur shumë e jemi takuar shpesh gjatë kësaj kohe. Më kërkonte ai, e kërkoi unë. E shihja se si lëvizte labirintit të ferrit të Dantës për ta nxjerrë në ditën për diell atë të padukshmen, të panjohurën. Një hutim intelektual që i lexohej në sy, në gojë, në ballë, sikur pyeste: "A do t'ia dal?" Ai na e solli këtu në tërë përmasën masakrën e Abrisë së Epërme: tragjedinë, dramën, vuajtjen, persekutimin, çmendinë njerëzore të pushtuesit; ai na e solli këtu listën e të vranëve, e të masakruarve, të të mbijetuarve; ai na i solli

këtu fotografitë e tyre, jetëshkrimet e tyre, varret e tyre; na e solli vogëlushen disajavëshe të mbijetuar nën trupin e nënës së vranë; na e solli Valmirin me biberon, të vranë pa i mbushur dy vjet; na e solli... Ah, mbani frymën! Na e solli FËMIJËN E PALINDUR që priste vetëm ditët të vinte në jetë. Një nuse në muajin e nëntë të shtatzënisë. Halla i thotë: "Moj bijë, unë e kam gjetë emnin e këtij fëmije. Do t'i them Malsor ose Malsore, se në mal e nisi jetën dhe ka me ardhë me emnin e vet". Jo, ai nuk erdhi. E vranë pushtuesit mizorë duke ia masakruar të ëmën. Fëmija i palindur, "Malësori" ose "Malësorja", nuk ka as varr, por ka djepin e përjetshëm në mitrën e nënës. Mjaft! Nuk mban më NJERIU. Ja, këtë na e solli Afrim Hysenaj. Kjo është monografia, ndër më të veçantat për luftën, që na dëshmon se ku i ka rrënjët liria jonë sot. Prishtinë, shtator 2018


E rrallë

Zbulohen dy skelete 6 000-vjeçarë

Dy skelete të vjetër njerëzish 6 000-vjeçarë, me dhëmbë të ruajtura në mënyrë të përkryer, janë gjetur gjatë punimeve në një rrugë në Brazil. Mbetjet u gjetën në një vend në rrugën BR-470 në komunën Ilhota. Skeletet dhe kockat e dhëmbëve duken të ruajtura mirë. Skeletet u gjetën rreth 60 centimetra nën sipërfaqe.



FOTO E DITES



Një punëtor mban një thes të miellit në provincën veriore të Hajjahut. /AFP/

E jashtëzakonshme

Realizon fustanin e nusërisë me thasë çimentoje

Shumica e fustaneve të nuses janë të bëra nga copa mëndafshi apo dantella, një grua në veriperëndim të Kinës ka impresionuar miliona njerëz duke krijuar një fustan mahnitës me thasë çimentoje. Tan Lili prodhoi të gjithë fustanin, së bashku me kapelën, me 40 thasë çimentoje të hedhura pas përdorimit.



BARSOLETA E DITËS



Mjeku: Me gjak, qysh jeni?
Plaku: Boll belaxhi jemi, po në gjak nuk jemi me askënd.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

“HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation” 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

Rolet: Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

Regjia: Genndy Tartakovsky



STRANGER THINGS... ARRIVAL

IF YOU'RE ONE OF US COME FIND US



Në ora 18:00 “THE DARKEST MINDS”

Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

Rolet: Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

Regjia: Jennifer Yuh Nelson

Në ora 20:00 dhe 22:00

“THE PREDATOR” 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 orë 47 min

Rolet: Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilara, Jake Busey, etj.

Regjia: Shane Black



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Me kalimin e Hënës në shenjën tuaj, humori do të jetë gjithmonë në nivel të lartë dhe do të arrini të kaloni këtë fazë aspak të lehtë nga ana emocionale.



DEMI

Duhet të keni pak forcë për t'i përmbyllur disa detyra familjare që duhen finalizuar sot. Pasi t'i kryeni do të ndiheni më të qetë dhe më të sigurt.



BINJAKËT

Personaliteti juaj është mjaft solar sot dhe do të tërhiqni pas vetes njerëz me humor të mirë dhe të cilët do të jenë mjaft besnik ndaj jush.



GAFORRJA

Ndiheni pak të plogësht sot dhe pa energji. Do të shtyni për një ditë tjetër të gjitha impenjimet dhe takimet që kishit lënë sot.



LUANI

Keni nevojë për aktivitet fizik dhe këtë gjë po e shikoni edhe në fizikun tuaj. Nuk duhet të bëni jetë kaq të shqetësuar nëse nuk doni të keni shqetësime fizike.



VIRGJËRSHA

Stresin e përditshëm dhe rutinën do të mundoheni ta shmangni duke u organizuar me miqtë dhe duke ndjekur aktivitete të ndryshme kulturore.



PESHORJA

Sfidat në çdo fushë të jetës ju intrigojnë dhe jeni i prirur t'i ndiqni. Sot do të shikoni që nuk jeni të vetmit që ju pëlqen kjo gjë.



AKREPI

Ana ekonomike ka shanse shumë të mira që sot të shkojë në nivele mjaft të larta falë një investimi të shkuar që nuk e keni menduar kaq fitimprurës.



SHIGJETARI

Vazhdon të jetë një ditë e bukur fundshtatori edhe sot për ju. Ndiheni të motivuar në të gjitha fushat e jetës dhe mjaft në humor.



BRICJAPI

Do të duhet të kaloni disa prova të vogla sot përpara se ta merrni rezultatin final të një bashkëpunimi shumëvjeçar që po arrin fundin.



UJORI

Edhe pse planetët i keni kundër sot, do të dini si ta gjeni ekuilibrin shpirtëror për të qenë sa më racional në vendimet që merrni për të ardhmen.



PESHQIT

Mendonit se asgjë nuk po shkon siç duhet, por kjo ndodh vetëm për shkak të disa problemeve të vogla që do t'i zgjidhni sa hap e mbyll sytë.

Belen, në krah të një "Kavaleri" të ri



Nëse Belen Rodriguez e di atë që kërkon, ashtu siç ka deklaruar në "Instagram" në ditën e 34-vjetorit të saj të lindjes, fansat kanë rënë "në errësirë". Për t'i përhapur idetë janë fotografitë e pub-

likuara në shtypin rozë italian që tregojnë modeluesen 34-vjeçare të shoqëruar nga një mashkull misterioz, i cili është identifikuar si Mirco Levati, ekspert i komunikimit dhe marketingut sportiv.

Tayna zbulon projektin më të ri muzikor



Ditë më parë reperja e famshme Tayna ka bërë me dije se shumë shpejt do ta sjellë projektin e ri muzikor, i cili do të jetë ndryshe nga të tjerët. Artistja, e cila është pjesë e kreut të "The Top List"

me tri projektet e saj muzikore, ka zbuluar titullin e këngës. Në fotografinë e postuar në "Instagram", Tayna ka zbuluar se ky projekt muzikor quhet "Doruntina" dhe momentalisht është në xhirimet e klipit.




Bashkëshortja e Sneijderit ndez "Instagram"-in

Modeluesja holandeze Yolenthe Cabau është një nga Wagsat më seksi në planet. Disa muaj më parë u përfol për një krizë në

marrëdhënien e saj me Wesley Sneijderit, por kur mesfushori mori një çmim me rastin e tërheqjes nga "Tulipanët", ai ia dedikoi pikërisht bashkëshortes së tij.

Reperi shkron në spital nga patatinat pikante



Reperi Lil Xan ka njoftuar përmes llogarisë së vet në "Instagram" se nga konsumimi i tepërt i patatinave pikante apo siç njihen në Amerikë, Hot Cheetos, u detyrua të shkonte në spital pasi ndihej

shumë keq. Ai u paraqit në spital pas djegies së madhe të stomakut dhe të vjellave të tepërta. Mirëpo, reperi ka treguar se përsëri do të vazhdojë t'i konsumojë ato, pasi që është ushqimi i tij i preferuar.

Çfarë ndodh me trupin tonë kur nderim një cigare?

Pirja e duhanit është përgjegjës për 85% të rasteve të kancerit të mushkërive dhe 70% të atyre në fshikëz. Mund të shkaktojë sëmundje serioze kardiovaskulare dhe respiratore. Te meshkujt mund të shkaktojë impotencën. Po ju listojmë dëmet që mund të shkaktojë pirja e cigares.

“Droga e përsosur”

Nikotina krijon varësi dhe e shtyn trurin të konsumojë gjithnjë e më shumë doza.

“Nikotina është një ilaç i vërtetë. Kjo është arsyeja pse fillimi i pirjes së duhanit është shumë më i lehtë sesa ndalja. Kjo substancë gjendet në gjethet e duhanit. Ndryshe nga drogat e tjera, të tilla si kokaina apo heroina, ajo nuk prodhon dëmtime në afat të shkurtër, por ka një kapacitet të lartë për të nxitur varësinë, duke e bërë atë afër të qenit “droga e përsosur”, lexohet në librin “Duhani. Pyetje dhe përgjigje për të kuptuar dhe zgjedhur”, botuar nga Fondacioni Umberto Veronesi.

Rreziku i kancerit

Pirja e duhanit është përgjegjës për 85% të rasteve të kancerit të mushkërive dhe 70% të atyre në fshikëz. Ajo gjithashtu kontribuon në lloje të tjera të neoplazisë: gojë, laring, stomak, mëlçi, pankreas.

“Mushkëria është organi më i ndjeshëm ndaj dëmtimit të pirjes së duhanit. Substancat e pranishme në të depozitohen në bronke, ku ato mund të dëmtojnë ADN-në e qelizave që nxisin transformimin e tumorit. Format më të zakonshme të kancerit të mushkërive të favorizuara nga pirja e duhanit janë: kanceri i mushkërive të qelizave të vogla dhe kanceri i qelizave squamous. Është vlerësuar se rreziku i zhvillimit të sëmundjes për një duhanpirës është rreth 15 herë më i lartë se jo duhanpirësit dhe madje deri në 20 herë nëse pini më shumë se 20 cigare në ditë. Për shkak se rreziku i kancerit të mushkërive kthehet në të njëjtat nivele si ata që kurrë nuk kanë pirë duhan, duhet 10-15 vjet si ish-duhanxhi”, thuhet në librin “Duhani. Pyetje dhe përgjigje për të kuptuar dhe zgjedhur”, botuar nga Fondacioni Umberto Veronesi.

Sëmundjet e zemrës

Pirja e duhanit përbën rreth 25% të sëmundjeve kardiovaskulare.

“Çdo cigare e tymosur rrit



rrezikon kardiovaskular. Duhanpirësit kanë dy deri në katër herë më shumë gjasa të përjetojnë një sëmundje kardiovaskulare sesa jo-duhanpirësit. Nga të gjitha vdekjet e shkaktuara nga sëmundjet kardiovaskulare, rreth një në pesë ka të bëjë me pirjen e duhanit. Tymi favorizon sëmundjet kardiovaskulare përmes mekanizmave të ndryshëm: ajo zvogëlon sasinë e oksigjenit që arrin zemrën, rrit presionin e gjakut dhe rrahjet e zemrës, duke dëmtuar murin e brendshëm të enëve të gjakut, nxit vasoconstriction ose spazmën e arterieve, rrit gjasat e zhvillimit të pllakave obstruktive dhe trombet në enët e gjakut. E gjithë kjo rrit mundësitë për të shkaktuar goditje në zemër. Duke ndaluar pirjen e duhanit, rreziku i sëmundjeve kardiovaskulare reduktohet pas rreth një viti. Pas 20 vjetësh afrohet me atë që nuk ka tymosur, thuhet në libër.

Çrregullime të frymëmarrjes

Pirja e duhanit mund të shkaktojë probleme serioze të frymëmarrjes (sëmundje pulmonare kronike obstruktive, bronkit dhe pneumoni).

“Bronkit kronik ndikon rreth gjysmën e duhanpirësve të rëndë dhe është rezultat i inflamacionit të shkaktuar nga pirja e duhanit në mushkëri. Ajo është paraqitur me kollë të shoqëruar nga pështyma ose gëlbaza. Ajo definohet si kronike kur simptomat vazhdojnë për më shumë se tre

muaj dhe ndodhin në të paktën dy vjet të njëpasnjëshme. Duke ndaluar pirjen e duhanit, simptomat e bronkitit kronik reduktohen pas një deri në dy muaj; për t’u kthyer në nivelet e një joduhanaxhiu, ajo zgjat rreth pesë vjet. Sëmundja pulmonare obstruktive kronike, në shkurtimin e COPD, është një sëmundje e frymëmarrjes e karakterizuar nga një pengesë e pakthyeshme e rrugëve ajrore, për të cilën deri më sot nuk ka trajtim efektiv. Pirja e duhanit e është shkak kryesor i COPD, kështu që ndërprerja e pirjes së duhanit është aktualisht e vetmja strategji efektive për të ngadalësuar rrjedhën e sëmundjes. Për fat të keq, edhe ndalimi i pirjes së duhanit nuk e rikthen funksionin e frymëmarrjes së humbur, pasi përgjithësisht dëmtimet e shkaktuara nga pirja e duhanit janë vetëm pjesërisht të kthyeshme.

Gjithashtu është treguar se pirja e duhanit rrit rrezikun e zhvillimit të astmës tek të rinjtë dhe të rriturit”, thuhet në libër.

Problemet seksuale

Pirja e duhanit mund të shkaktojë mosfunksionim erektil dhe impotencë te meshkujt.

“Dëmet në enët e gjakut të shkaktuara nga pirja e duhanit gjithashtu ndikon edhe në shëndetin e penisit dhe veçanërisht në erektime. Penisi është në fakt një organ shumë i vaskularizuar dhe kjo varet nga funksionaliteti i tij vetëm nga një furnizim i rregullt i gjakut: kur zvogëlohet, ose presioni është i pamjaftueshëm,

mund të lindin probleme. Shanset për t’u zhvilluar mosfunksionim erektime bëhet edhe më i lartë kur sëmundja kardiovaskulare është gjithashtu e lidhur me pirjen e duhanit. Pirja e duhanit mund të zvogëlojë pjellorinë edhe në burra ashtu edhe në gra. Te meshkujt pirja e duhanit zvogëlon cilësinë e spermës: Disa studime kanë treguar se substancat toksike që gjenden në tym arrijnë në spermë, duke kompromentuar lëvizshmërinë e spermatozoideve dhe duke reduktuar aftësinë e tyre për të fekunduar ovocitin. Te gratë, pirja e duhanit vepron negativisht në ovulacion dhe lidhet me menopauzën e hershme. Është vlerësuar se pirja e duhanit ul me rreth 40 për qind shanset e konceptimit”, thuhet në libër.

Çrregullime në shikim

Pirja e duhanit promovon sindromën sy të thatë, katarakte dhe degjenerim makular.

“Vlerësohet se çdo cigare përmban të paktën 600 përbërës, të cilët kur digjen u japin jetë më shumë se 7 mijë molekulave të ndryshme. Nga këto, rreth 70 tani njihen si të aftë të shkaktojnë kancer; për shumë të tjerë dihet aftësia për të shkaktuar dëme në shëndetin, aq shumë sa që përdorimi i tyre shpesh është i rregulluar. Disa nga këto substanca gjithashtu pengojnë aftësinë vizuale. Për shembull, acid acetik, i cili mund të irrijojë sytë, mushkëritë dhe rrugët e frymëmarrjes. Ose toluen, një hidrokarbure aromatike e përdorur si tretës, gjithashtu në pro-

ceset e shtypjes dhe në ngjyra, dhe si një antiknocker në benzinë; ka një veprim të dëmshëm në sistemin nervor, veshkat dhe sytë”, thuhet në libër.

Infeksionet dhe tumoret e gojës

Pirja e duhanit ul mbrojtjen e imunitetit: pllaka bakteriale dhe rritja e gurit në gojë.

“Goja është faza e parë e pirjes së duhanit në udhëtimin e saj në mushkëri dhe është ndër fushat e trupit që vuan më së shumti dëmet. Dhëmbët e verdhë dhe njollë, janë më të prirur për pllakatë dhe akumulimin e kariesit. Mishrat, për shkak të rritjes së pllakës dhe kariesit dhe zvogëlimit të përmbajtjes së oksigjenit në gojë, janë më të prirur ndaj infeksioneve bakteriale që mund të shkaktojnë periodontiti. Ky është një inflamacion serioz i strukturës që mbështet dhëmbët dhe që vjen me tërheqjen e mishit të dhëmbëve, lëvizshmërinë dentale deri në rënien e dhëmbëve, gjë që në duhanpirës të rëndë ka gjasa më shumë. Infeksionet orale të tilla si kandidiaza janë më të shpeshta në duhanpirësit. Së fundi, 80 për qind e të gjitha tumoreve malinje të gojës i atribuohen përdorimit të duhanit”, thuhet në libër.

Plaket lëkura

Tymi është shkak për zverdhjen e gishtave dhe thonjve, plakjes së lëkurës, rrudhave të rritura.

“Shumë duhanpirës kanë thonjtë dhe lëkurën që i rrethojnë me një ngjyrë të verdhë. Kjo është në përgjithësi për shkak të akumulimit të katranit dhe nikotinës në zonat e gishtave ku mbahet cigarja. Çdo herë që thithni një frymë nga një cigare enët e vogla të gjakut tkurren dhe zvogëlohet përqendrimi i oksigjenit në gjak. Kjo gjithashtu ka një efekt të drejtpërdrejtë në lëkurën e cila, e privuar nga oksigjeni, tenton të duket e shurdhër dhe e errët. Tymi gjithashtu shkakton lirimimin e radikaleve të lira në trup që pengojnë prodhimin e kolagjenit dhe dëmtojnë proteinat që kontribuojnë në strukturën e lëkurës. Së bashku, këto dy fenomene favorizojnë plakjen e lëkurës me humbjen e elasticitetit, shfaqjen e njollave të lëkurës dhe formimin e rrudhave, veçanërisht në zonën rreth buzëve. Pirja e duhanit gjithashtu shkakton një rritje në hirsutism (rritjen e flokëve) të fytyrës”, thuhet në libër.

(gazeta-Shqip.com)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BRISTOL CITY - ASTON VILLA

GG

DUNFERMLINE - PARTICK

1

HOLSTEIN KIEL - DARMSTADT

1

Gërbeshi: Pas Prishtinës, radhën e ka Gjilani

Fidan Gërbeshi, pas fitores ndaj Prishtinës, po kërkon edhe një fitore tjetër ndaj Gjilanit, në ndeshjen më të rëndësishme në futbollin e Kosovës. "Të gjithë e dimë se ky është ndër tre apo katër ekipet më të mëdhenj në Ballkan, prandaj edhe dëshira futbollistëve për fitore është e madhe", ka thënë Fidan Gërbeshi

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Mbrojtësi Fidan Gërbeshi beson se Drita do ta fitojë derbin ndaj Gjilanit i cili llogaritet si derbi më i madh në futbollin e Kosovës. Kjo ndeshje zhvillohet të dielën në qytetin e Gjilanit nga ora 15:30. Gërbeshi të enjten për "Epokën e re" ka thënë se futbollistët e Dritës do ta japin maksimumin për të shënuar fitore, kurse ka ftuar edhe tifozët "Intelektualët" të jenë në numër sa më të madh në stadium. "Të gjithë e dimë se ky është ndër tre apo katër ekipet më të mëdhenj në Ballkan, prandaj dëshira e futbollistëve për fitore është e madhe. Në kemi pasur një ngecje, por pas fitores ndaj Prishtinës dhe me një fitore tjetër do të hyjmë në serinë e rezultateve pozitive. Kërkoj nga 'Intelektualët' të jenë në numër sa më të madh për të na përkrahur, kurse maksimumi nga ne nuk do të mungojë", ka thënë Gërbeshi, i cili me këtë rast ka konfirmuar se mungesa e vetme në formacionin e trajnerit Shpëtim Duro do të jetë ajo e Liridon Lecit për shkak të kartonit të kuq që mori në ndeshjen e fundit ndaj Prishtinës.

Tri pikët në ndeshjen e xhiros së kaluar e kanë motivuar shumë Dritën për ndeshjet e radhës. "Atmosfera në klub është e mirë pas fitores ndaj Prishtinës, e cila gjithmonë është një kundërshtarë e vështirë dhe pre-



tendente për titull. Ato tri pikë na kanë dhënë edhe më shumë motiv për ta kërkuar maksimumin edhe në ndeshjet e radhës", ka shtuar Gërbeshi.

Ditë më parë nga skuadra kampione është larguar trajneri Bekim Isufi, kurse vendin e tij e ka zënë trajneri nga Shqipëria, Shpëtim Duro. Lidhur me këtë ndryshim në shtabin teknik, Gërbeshi ka deklaruar: "Secili trajner e ka filozofinë e vet dhe nuk ka ndryshuar diçka në klub për faktin se është një periudhë e shkurtër. Të vetmen gjë që do ta përmendi me këtë rast është se vetëm disiplina është më e madhe". Skuadra e Dritës aktualisht pozicionohet e dhjeta me vetëm gjashtë pikë.

Sot zhvillohen dy ndeshje në Superligë

Sot (e premte) do të zhvillohen dy ndeshje të javës së shtatë në IPKO Superligë. Në orën 15:30 në stadiumin "Riza Lushta" në Mitrovicë, Trepça '89 e pret skuadrën e Ferizajt, kurse në Skenderaj do të ballafaqohen Drenica dhe Ballkani. Të shtunën janë në program dy ndeshjet e tjera, takohen Feronikeli - Liria dhe Llapi - KEK-u. Kjo xhiro mbyllet të dielën në mes Gjilanit dhe Dritës dhe Prishtinës dhe Flamurtarit. Ndeshja në mes të skuadrave nga kryeqyteti zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 18:45.

Gashi: Objektivi ynë, ngritja e pjesëmarrjes në aktivitete sportive

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Komiteti Olimpik i Kosovës ka hapur Panairin e Sportit të enjten në Sheshin "Skënderbeu", në kuadër të Javës Evropiane të Sportit. Qëllimi i këtij Panairi është që klubet sportive të komunave t'i paraqesin ofertat e tyre tek fëmijët e shkollave fillore, të cilët vendosin se cili sport është më atraktiv dhe më joshës për t'u marrë me të. Në këtë panair mori pjesë edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, i cili shprehu kënaqësinë për këtë organizim të KOK-ut. "Organizimi i Javës Evropiane të Sportit, bashkëpunimi i Ministrisë me Komitetin Olimpik të Kosovës, me federatat e sporteve të ndryshme, në të njëjtën kohë edhe me klube të ndryshme, ka bërë dhe është dëshmia më e mirë se një bashkëpunim i mirë e masivizon dukshëm sportin në Kosovë, edhe për faktin se nga statistikat një numër shumë i ulët i të rinjve tanë marrin pjesë në sport. Kjo na bën të gjithëve të bashkohemi e të



koordinohemi që dokumentet tona strategjike të kenë ndryshime dhe objektiva të qarta që ta kenë ngritjen e pjesëmarrjes në aktivitete sportive", ka thënë ministri Gashi. "Unë si ministër dhe të gjitha federatat dhe

Komiteti Olimpik do të jemi fuqishëm të angazhuar që gjatë vitit 2019 të punojmë që qytetarët të jenë pjesë e aktiviteteve sportive, që ta ngrahim përqindjen e pjesëmarrjes në aktivitete sportive", ka deklaruar Gashi.

SHKURT

Kloppi sqaron zënkën me Shaqirin

Jurgen Kloppi është parë gjatë gjithë kohës i acaruar me veprimet e Xherdan Shaqirit në fushë, në ndeshjen kundër Liverpoolit (2-1). I pyetur në fundin e takimit për fjalët e drejtuara ndaj shqiptarit, Kloppi ka sqaruar situatën. Ai zbuloi se bëhet fjalë për një goditje dënimi që duhet ta bënte Shaqiri dhe e ekzekutoi Hendersoni. "Fola për një goditje të lirë në fund. Doja që krosimi të ishte për Salahin në shtyllën e dytë, sepse po ta nxirrnin përballë portierit, nuk do të ishte dhe aq keq. Kaq është e gjitha", ka thënë Kloppi.

Challandesi fton Kryeziun tek Kosova

Kosova do të zhvillojë një ndeshje ndaj skuadrës së Maltës në kuadër të Ligës së Kombeve në stadiumin "Fadil Vokrri". Për këtë ndeshje trajneri Bernard Challandes ka grumbulluar edhe një mbrojtës të talentuar, Mirlind Kryeziu. 21-vjeçari është pjesë e skuadrës së Zyrilhut në Zvicër dhe ka luajtur rregullisht atje. Kryeziu ka qenë pjesë edhe e grupmohave të Zvicrës duke filluar nga U-16 deri tek U-20.

Një ndeshje dënim për Ronaldon

Cristiano Ronaldo është dënuar nga UEFA me vetëm një ndeshje moslojë për shkak të kartonit të kuq që e mori në ndeshjen ndaj Valencias në Ligën e Kampioneve. Portugezi do të mungojë vetëm në ndeshjen ndaj Young Boysit dhe do të jetë i gatshëm për rikthimin në "Old Trafford" ndaj Manchester Unitedit. Ronaldo u ndëshkua me karton të kuq pasi kapi për flokësh mbrojtësin Murillo.

Gjermania do të organizojë "Euro 2024"

Komiteti Ekzekutiv i UEFA-s ka vendosur që Gjermania do të jetë organizatorja e Kampionatit Evropian të vitit 2024 pas votimit që u realizua në Nion të Zvicrës, aty ku projekti gjerman mundi atë turk. Berlina, Këlni, Dortmundi, Dyseldorfi, Frankfurti, Hamburgu, Lajpcigu, Shtutgarti dhe Mynihu do të jenë qytetet ku do të luhen ndeshjet. Gjermania ka organizuar më parë edhe Evropianin e vitit 1988, përveç Botërorëve të vitit 1974 dhe 2006.

Puyoli: Messi, më i miri në botë

BARCELONË, 27 SHTATOR - Carlos Puyol ka komentuar zgjedhjen e Luka Modriqit si lojtari më i mirë nga FIFA. Ish-lojtari i Barcelonës e ka vlerësuar lojtarin e Realit, por sërish ka theksuar se më i miri në botë është "pleshti", të cilin e ka

pasur shok skuadre për shumë vite. "Ne duhet t'i respektojmë ata që vendosin, por njerëzit e futbollit e dinë se kush është më i mirë. Modriqi është një lojtar i madh që ka bërë një sezon shumë të mirë, por për mua më i miri është Messi. E

uroj Modriqin. Leo nuk mund të fitojë gjithnjë, pasi ne na duhej më pas të krijonim një çmim për të dhe një për të tjerët", ka thënë Puyol. "Humbja e Barcelonës? Ju rinisi që të fitojë çdo javë dhe me një humbje nisin menjëherë

kritikat. Ata duhet të luftojnë për çdo trofe, por normalisht nëse mendohet për Ligën e Kampionëve dhe Kupë, atëherë dihet se do të zgjedhim Ligën e Kampionëve por, mbi të gjitha, është La Liga", ka shtuar Puyol.



Infantino: Dyert e FIFA-s do të jenë gjithmonë të hapura për Kosovën

PRISHTINË, 27 SHTATOR (ER) - Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, ka premtuar mbështetje për kryetarin Agim Ademi dhe Federatën e Futbollit të Kosovës. Infantino ka thënë se dyert e FIFA-s gjithmonë janë të hapura për futbollin e Kosovës. "Ne do ta mbështesim presidentin Ademi në vizionin dhe strategjinë e tij përmes projekteve dhe me të gjitha mundësitë në mënyrë që t'i realizojë objektivat e tij. Për presidentin Ademi dhe FFK-në dyert e FIFA-s do të jenë gjithmonë të hapura", ka thënë Infantino pas takimit me drejtuesit e FFK-së, Agim Ademi (kryetar), Flamur Bunjaku (anëtar i KE) dhe sekretarin e Përgjithshëm, Eroll Salihu. Në këtë takim të pranishëm ishin edhe Zvonimir Bobanin dhe Bjorn Vlassalo.

Federata e Futbollit të Kosovës ka bërë me dije nëpërmjet një njoftimi për medie se kryetari Agim Ademi e ka njoftuar Infantinon se Kosova ka kaluar në një periudhë të vështirë nën okupim, por vullneti dhe përkushtimi i njerëzve e ka mbajtur gjallë frymën e futbollit dhe pranimi i futbollit të Kosovës në UEFA dhe FIFA ishte gjëja më e drejtë që kanë marrë këto dy insti-



tucione. "Ademi e njoftoi presidentin e FIFA-s, Gianni Infantinon, për zhvillimin e futbollit në Kosovë, përkushtimin për ngritjen e cilësisë së ligave. Përkujdesja dhe ngritja e shkollave të futbollit. Puna me të rinj e të reja, me theks të veçantë futbollit i femrave. Zhvillimi i futbollit shkollor dhe përfshirja e tyre në turnetë e ndryshme, sikur edhe me nevoja të veçanta. Po ashtu edhe projekti

Grassrotts. Për zhvillimin e futbollit dhe ekipeve kombëtare. Po ashtu presidenti Ademi e njoftoi mikpritësin për angazhimin maksimal të tij për realizimin e projekteve në infrastrukturë, për ngritjen profesionale të FFK-së, të trajnerëve dhe gjyqtarëve. Presidenti Ademi falënderoi presidentin Infantino edhe për punën me gjyqtarë", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Mediet greke lavdërojnë Mavrajn

SELANIK, 27 SHTATOR - Impakti që pati debutimi i Mërgim Mavrajt, në derbin e Selanikut ndaj PAOK-ut, ka qenë i paimagjineshëm në ligën greke. Tekniku i Arisit e filloi ndryshe 11-shen e tij në ndeshjen në mes të PAOK-ut dhe Arisit, e cila përfundoi në paqe 1-1. Ndryshimi ishte mbrojtësi qendror. Më shumë sesa moslejimi i PAOK-ut që ta fitonte këtë sfidë, gazetarëve grekë u ka bërë përshtypje futbollisti shqiptar. Elementi i ri në formacion ka bërë që të gjithë të shkruajnë për të, veçanërisht kanë vlerësuar maturinë dhe korrektësinë në lojën e tij. "Gazzetta.gr" i ka kushtuar një shkrim të plotë me titull: "Nga tradhtar në hero", duke treguar historinë e 32-vjeçarit se si refuzoi pritjen për t'u bërë pjesë e ekipit kombëtar gjerman dhe zgjodhi ekipin kuq e zi. Është përmendur edhe lidhja e tij e ngushtë me fenë, madje kanë veçuar kërkesën e Mërgimit për të mos mbajtur reklamën e birrës "Peja" në bluzë. Një tjetër gazetë shkruan "më i miri për në fund", një futbollist "top-klasë" dhe me një karakter të veçantë.



SHKURT

Milani mendon për Fabregasin

Milani këtë sezon ende nuk ka gjetur formën e duhur dhe duket se skuadra vuan mungesën e një organizatori. Leonardo po shikon mundësitë për të ndërhyrë në afatin kalimtar të janarit me një emër të rëndësishëm, atë të Cesc Fabregasit. Spanjoli mund të jetë një mundësi e mirë edhe nga ana ekonomike, pasi është në muajt e fundit të kontratës dhe në janar, me një ofertë jo shumë të lartë, fantazisti mund të bindet që të largohet nga Chelsea. Edhe Sarri nuk e shikon Fabregasin titullar, ndaj operacioni ka shumë shanse të konkretizohet në favor të Milanit.

Humbja nga Leganesi, zhgënjën Valverden

Barcelona në dy ndeshjet e fundit i ka humbur pesë pikë në kuadër të La Ligës. Trajneri i katalonasve, Ernesto Valverde, ka qenë i shokuar pas humbjes së skuadrës së tij nga Leganes me rezultatin 2-1. "Ky është futboll. Nganjëherë është e vështirë t'i shpjegosh gjërat që ndodhin në një ndeshje. Ne e kontrolluam ndeshjen, por ata e dinin si të na dënojnë brenda një minute", ka thënë Valverde.

Marcelo: Humbja dhemb më shumë se lëndimi

Marcelo ka pësuar një lëndim në humbjen e Real Madridit ndaj Sevilas, por thotë se humbja është më negative. Reali humbi me rezultat 3-0 nga Sevilla në La Liga dhe për Marcelon kjo është gjë larg më negative. "Unë pësova një goditje, por humbja dhemb më shumë", ka deklaruar Marcelo.

Ramsey i vendosur të largohet nga Arsenal

Aaron Ramsey pritet të largohet nga Arsenalin në afatin kalimtar të verës si lojtar i lirë pasi nuk po arrin marrëveshje për rinovimin e kontratës. Sipas mediumit "The Mirror", Ramsey është i vendosur për ta lënë Arsenalin në verë pasi bisedimet mbi një kontratë të re janë ndërpreur. Marrëveshja aktuale e 27-vjeçarit skadon në fund të sezonit dhe "Topçinjtë" refuzuan një ofertë 50 milionë funte për shërbimet e tij këtë verë, pasi ata dukeshin të sigurt për mbajtjen e lojtarit. Por, ka pasur një prishje të papritur raportesh në bisedimet mes palëve.

Portieri i Leganesit: Askush nga Barça nuk na uroi

Portieri i Leganesit, Ivan Cuellar, ishte më meritori për fitoren e skuadrës së tij ndaj Barcelonës (2-1). Ai u ankua për mungesën e sportivitetit të lojtarëve të Barcelonës. "Është e vërtetë që jemi Leganes, një ekip i përulur, por më pëlqen që kundërshtarët të sillen me sportivitet ndaj nesh. Disa lojtarë dhe skuadra mund të jenë mësuar më së shumti të fitojnë, por ja që edhe humbet në futboll. Kur humbet duhet ta përshëndesësh dhe përgëzosh ekipin tjetër, diçka që lojtarët e Barcelonës nuk e bëjnë. Askush nuk erdhi për të na uruar, askush prej nesh nuk është përgëzuar. Unë mendoj se ky është një gjest mjaft i shëmtuar", ka thënë Cuellar.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës shpallë:

KONKURS

1. Departamenti i Llogarive Kombëtare një (1) pozitë e karrierës-rishpallje

Titulli: Një (1) Drejtor të Departamentit të Llogarive Kombëtare

Numri i referencës: ASK-DLLK-001

Koeficienti: 10

Detyrat kryesore:

- Bën menaxhimin dhe organizimin e punëve të Departamentit të Llogarive Kombëtare, përgjegjës për planifikimin, realizimin, dhe mbikëqyrjen e politikave të departamentit (realizimi i planit sipas afatit kalendarik, implementimi i klasifikimeve të reja sipas planit vjetor të paraparë, përmirësimi i kualitetit përmes aktiviteteve shtesë të kontrollit me raporte).
- Udhëheqë punët në përgatitjen e programit dhe planit operativ të hulumtimeve statistikore, bënë planin njëvjeçar të punës dhe përgatitjen e programit pesëvjeçar të punës.
- Mbikëqyrë të gjitha fazat statistikore (përgatitjen e instrumenteve statistikore, grumbullimin, përpunimin, analizimin dhe publikimin e të dhënave statistikore).
- Vë në shfrytëzim klasifikimet, standardet dhe metodologjitë e Eurostat-it për zhvillimin e statistikave për Llogaritë kombëtare dhe qeveritare, për të dhënat për ekonominë e pavaruar, si dhe jep propozime për avancimin dhe azhurnimin e Llogarive Kombëtare.
- Siguron krahasueshmërinë e të dhënave statistikore të Kosovës me ato ndërkombëtare.
- Bën vlerësimin kualitativ të të dhënave nga publikimet dhe kujdeset për aftësimin profesional të stafit. Mbikëqyrë në kohë të gjitha materialet e përgatitura për publikim sipas planit dinamik.
- Përgatitë raportet e punës javore, mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore.
- Kryen detyra të tjera shtesë sipas kërkesës së KF.

Kualifikimi: Diplomë universitare në fushat ekonomike.

Përvoja e punës: kandidati duhet të ketë 7 vite përvojë pune dhe atë 4 vite përvojë pune në vende udhëheqëse.

Kompetenca dhe aftësitë:

- Të menduarit strategjik lidhur me planifikimin dhe menaxhimin,
- Njohuri mbi indikatorët makroekonomik,
- Të ketë shkathësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë,
- Shkathësi të dëshmuara të zhvillimit të mbajtjes së trajnimit, instruktimit dhe monitorimit,
- I/E vetë- motivuar, i aftë të mësojë shpejt, fleksibil dhe i gatshëm të punojë nën presion,
- Shkathësi në udhëheqje dhe menaxhim,
- Njohuri të punës me kompjuter (Word, Excel, Access, SPSS, etj),
- Njohuri shumë të mira nga gjuha angleze.

2. Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit, një (1) pozitë e karrierës:

Titulli: Një (1) Zyrtar për statistika në Prizren

Numri i referencës: ASK-DRA-002

Koeficienti: 7

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Shpërndan anketat për të gjitha hulumtimet në nivel të rajonit,
- Kujdeset për shpërndarjen distribuimin dhe grumbullimin e raporteve mujore të ABESII, hotelierisë dhe turizmit në terren, (është bartës i hulumtimit të ABESII-it), statistikave e bujqësisë si pylltarin dhe anketën e mbeturinave, dhe pjesërisht statistikave të arsimit.
- Kontaktin me respondentet,
- Udhëzon plotësimin e formularëve të anketave statistikore,
- Bënë analizën logjike të hulumtimeve statistikore,
- Kujdeset për shpërndarjen distribuimin dhe grumbullimin e raporteve në terren,
- Me kërkesën e udhëheqësit të zyrës rajonale, përcjell dhe monitoron personat e angazhuar në terren gjatë procesit të implementimit të projektit.
- Raporton të udhëheqësi i zyrës rajonale për dinamiken e aktiviteteve sipas agjencës që ka parashtruar Departamenti i ASK.

Kualifikimi: Diploma universitare- nga fushat ekonomike, shoqërore dhe juridike,

Përvoja e punës: kandidati duhet të ketë 2 vite përvojë pune profesionale.

Kompetenca dhe aftësitë:

- Njohja e kompjuterit (Word, Excel, Outlook),
- Bashkëpunimi në mënyrë ekipore e nevojshme,
- Të ketë aftësi të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave individuale statistikore.
- Shkathësi në realizimin e punëve dhe detyrave sipas planit vjetor të zyrës rajonale
- Shkathësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;

Procedura e konkurimit:

Në Shërbimin Civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, përgatitje të nevojshme arsimore dhe aftësi profesionale për zbatimin funksionit administrativ dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja e Shërbyesve Civilë bëhet në pajtim me Ligjin -Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit: Sipas Ligjit të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, në të cilën është përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarik nga dita e publikimit në mjetet e informimit.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencionin e Statistikave të Kosovës, Rr. "Zene Salihu" nr.4 Prishtinë. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, dëshmi mbi përvojën e punës, vërtetimin nga Gjykata që personi nuk është nën hetim dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkojnë për vendin e punës për të cilin konkurron.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038-20031149, prej orës 08:00 - 16:00.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

"Komuniteti jo - shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

 REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ	 FERIZAJ
DREJTORIA E ARSIMIT UPRAVA ZA OBRAZOVANJE DEPARTMENT OF EDUCATION	Tel / Fax _____ Adresa _____ E-mail _____
NR/BR.	27.09.2018 1509
PËR/ZA/TO	Publikim të konkursit për mësimdhënës
NGA/OD/FROM	Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Afrim Llabjani
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Sektorit administrativ të Drejtorisë së Arsimit
LËNDA/PREDMET/SUBJEKT	Konkurs për mësimdhënës

Mbështetur në nenin 8, të Ligjit të Punës, nëni 35 paragrafi 1.4 dhe 5 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, nëni 5 pika e, i Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ të MASHT, it nr.10/2018 dhe 05/2015. Normativi për Kuadrin e Arsimit të Përgjithshëm dhe Arsimit Profesional të MASHT, Drejtoria e Arsimit në Ferizaj shpall:

KONKURS PËR MËSIMDHËNËS

- Në SHFMU "Halit Ibishi" në f. Cërnillë:
- Një mësimdhënës për histori, me plotësim në shkolla tjera, për 18 orë, (në zëvendësim).
- Në SHFMU "Tefik Çanga" në Ferizaj:
- Një mësimdhënës për gjuhë angleze (në zëvendësim).
- Në SHFMU "Pesë Dëshmorët e UÇK,së" në Pleshinë:
- Një mësues klase, (në zëvendësim).
- Në SHFMU "Dituria" në Dardani:
- Një mësimdhënës për biologji për 18 orë (në zëvendësim).
- Në SHMI të Agrobiznesit dhe Teknologjisë "Zenel Hajdini" në Ferizaj:
- Një mësimdhënës për gjuhë shqipe për 10 orë.

Kushtet: Për vendet e punës për mësimdhënës kërkohej përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimeve Administrativ të MASHT- Normativi për kuadrin e arsimit të përgjithshëm dhe në arsimin profesional.

Të drejtë aplikimi kanë kandidatët me përgatitje profesionale përkatëse.
Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën për shërbimin e qytetarëve, për Drejtorinë e Arsimit. Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin në vijim:
-Diplomën, ose Certifikatën e diplomës së fakultetit, kopje e vërtetuar,
-Certifikatën e lindjes,
-Letërnjoftimi kopje,
Kohëzgjatja e Kontratës së punës fillon prej datës së fillimit të punës, deri në kthimin e mësimdhënëseve nga pushimi i lehomnisë, më së voni deri më 30.06.2018, ndërsa për vendet e lira deri më 31.08.2019. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Dokumentet nuk kthehen.

Afati i konkursit është 15 ditë nga data e publikimit, në tabelën e shpalljeve, në web faqen e Komunës dhe në njërën nga mjetet e shkruara të informimit, duke filluar prej datës 27.09.2018, deri më 11.10.2018.

DA - Ferizaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova -
Kosovo Agency of Statistics*

Na osnovu Zakona Br. 03/Z-149 o Civilnoj Službi Kosova i Pravilnika Br.02/2010 o Procedurama Rekrutacije u Civilnoj Službi Republike Kosova, Agencija za Statistiku Kosova raspisuje:

KONKURS

1.Odeljenje Statistika Nacionalnih Računa jedna (1) pozicija od karijere-ponovo raspisuje

Naziv radnog mesta: Jedan (1) Direktor Odeljenja Statistika Nacionalnih Računa

Referentni broj: ASK-OSNR-001

Koeficijent : 10

Glavni zadaci:

1. Upravlja i organizuje rad Odeljenja Nacionalnih Računa, odgovoran je za planiranje, realizaciju i praćenje politika odeljenja (sprovođenje plana prema kalendarskom roku, implementacija novih klasifikacija prema predviđenom godišnjem planu, poboljšanje kvaliteta kroz dodatne aktivnosti kontrole izveštajima).
2. Rukovodi radove u pripremi programa i operativnog plana statističkih istraživanja, izrađuje jedanogodišnji plan rada i priprema petogodišnji program rada.
3. Prati sve statističke faze (pripremu statističkih instrumenata, prikupljanje, obradu, analizu i objavljivanje statističkih podataka).
4. Koristiti klasifikacije, standarde i metodologije Eurostat-a za razvoj Ekonomskih Statistika i Nacionalnih Računa i daje predloge za unapređenje i ažuriranje Nacionalnih Računa.
5. Obezbeđuje uporedivost statističkih podataka Kosova sa međunarodnim podacima.
6. Vršiti kvalitativnu procenu podataka iz publikacija i vodi računa o stručnom usavršavanju osoblja. Prati pravovremeno objavljivanje svih pripremljenih materijala prema dinamičkom planu.
7. Priprema nedeljne, mesečne, kvartalne, polugodišnje i godišnje izveštaje o radu.
8. Obavlja i dodatne zadatke na zahtev ID-a.

Kvalifikacija: Univerzitetska diploma u oblasti ekonomije.

Radno iskustvo: Kandidat mora imati 7 godina radnog iskustva i 4 godine radnog iskustva na rukovodećim pozicijama.

Nadležnosti i veštine:

- Strateško razmišljanje o planiranju i upravljanju,
- Znanje o makroekonomskim pokazateljima,
- Dokazane i efikasne veštine pisane i usmene komunikacije,
- Dokazane veštine održavanja obuka, davanja instrukcija i praćenja napretka,
- Samo motivisan/a sposoban da uči brzo, fleksibilan i spreman da radi pod pritiskom,
- Veštine u rukovodstvu i upravljanju,
- Poznavanje rada na računaru (Word, Excel, Access, SPSS, itd),
- Dobro poznavanje engleskog jezika.

2. Odeljenje Popisa i Anketa, jedna (1) pozicije od karijere

Naziv radnog mesta: Jedan (1) Službenik za Statistiku u Prizrenu

Referentni broj: ASK-OPA-002

Koeficijent : 7

Zadaci i odgovornosti:

1. Distribuirati ankete za sva istraživanja na regionalnom nivou,
2. Vodi računa o isporuci , distribuciji i sakupljanju mesečnih izveštaja o ABD-u, Ugostiteljstvu i turizmu na terenu (je nosilac istraživanja o ABD-u), poljoprivrednoj statistici kao što su šumarstvo i anketa o otpadu i delimično o statistici obrazovanja,
3. Kontaktira ispitanike,
4. Daje uputstva o popunjavanju obrazaca statističkih istraživanja,
5. Vršiti logičku analizu statističkih istraživanja,
6. Vodi računa o isporuci , distribuciju i sakupljanju izveštaja na terenu,
7. Na zahtev šefa regionalne kancelarije prati i nadgleda lica koja su angažovana na terenu tokom procesa realizacije projekta,
8. Izveštava šefu regionalne kancelarije o dinamici aktivnosti prema dnevnom redu koji je podnet od Odeljenja ASK-a.

Kvalifikacija : Univerzitetska diploma u oblasti ekonomije, socijalnih i pravnih nauka.

Radno iskustvo: kandidat mora imati 2 godine stručnog radnog iskustva.

Nadležnosti i veštine:

- Poznavanje rada na računaru (Word, Excel, Outlook),
- Potrebna sposobnost saradnje i timskog rada,
- Të ketë aftësi të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave individuale statistikore.

-Sposobnost da čuva poverljivost pojedinačnih statističkih podataka.

- Veština u izvršavanju poslova i zadataka prema godišnjem planu regionalne kancelarije
- Dobre veštine komuniciranja, uključujući sposobnost da tumači informacije, daje uputstva i prenosi informacije drugima;

Procedura konkurisanja:

U Civilnoj Službi imaju pravo da budu zaposleni punoletni građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost da deluju, koji su u posedu građanskih i političkih prava, koji imaju potrebnu obrazovnu spremu i stručnu sposobnost za obavljanje potrebnih zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

Zakonksi i podzakonski akti koji regulišu regrutovanje:

Izbor Civilnih Službenika vrši se u skladu sa Zakonom br. 03/Z-149 o Civilnoj Službi Kosova i Pravilnika Br.02/2010 o Procedurama Rekrutacije u Civilnoj Službi.

Trajanje imenovanja: U skladu sa Zakonom o Civilnoj Službi Republike Kosova u kojem je predviđen i period probnog rada u trajanju od jedne (1) godine.

Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja u javnim medijima.

Uzimanje i podnošenje aplikacija:

Aplikacije se uzimaju i dostavljaju u Agenciju za Statistiku Kosova , Ul. "Zenel Salihu" br.4, Priština.

Uz aplikacije potrebno je priložiti i kopije dokumenata o kvalifikacijama, dokaz o radnom iskustvu, potvrdu suda da osoba nije pod istragom i ostalu potrebnu dokumentaciju koja je potrebna za radno mesto za koju se prijavljujete. Zahtevi podneti nakon isteka roka konkursa neće biti prihvaćeni.

Nepotpune prijave biće odbijene.

Zbog velikog broja primljenih prijava, samo kandidati koji uđu u uži izbor biće kontaktirani.

Kandidati izabrani u uži izbor biće pismeno testirani i intervjuisani.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kadrovsku Kancelariju na broj telefona: : 038- 200 31 149 od 08:00 – 16: 00 časova.

"Kosovska Civilna Služba pruža ravnopravnu mogućnost zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije svih lica muškog i ženskog pola iz svih nacionalnosti na Kosovu."

"Ne-većinske nacionalnosti i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u centralnim i lokalnim organima civilne službe javne administracije, kako je specificirano u Članu 11, st. 3 Zakona Br. 03/Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova".

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: **"Hasan Prishtina"-Tërpezë**

Komuna: Malishevë

Data: **27.09.2018**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/150-ESIP/SDG/150-CS/1.1	Blerja e mjeteve të kabinetit të TIK-ut me mjete të nevojshme

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP)*, dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës **"Hasan Prishtina"-Tërpezë-Malishevë**. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimit të nevojshme:

Përshkrimi i mallrave të nevojshme :

1. Laptop – 3 copë
2. Projektor – 5 copë

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën e shkollës **"Hasan Prishtina"-Tërpezë-Malishevë**. më së largu deri më **05.10. 2018**.

4. Termet e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentët luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Emine Krasniqi
Telefoni: 044-652-993, 049-296-845
E-maili: emi-2008@live.com



Dy vite pa ty bashkëshorte dhe reja jonë

Filloreta Hykolli

(25.04.1982-28.09.2016)

Ishe një grua e mrekullueshme e sinqertë dhe e dashur për të gjithë ne. Gjithmonë do të mbetesh në mendjet dhe zemrat tona.

E përkujton: bashkëshorti Bujari, vjehrrri Rexhepi, vjehrra Xhevria, kunata Mirjeta, kunetët Avdushi, Banushi, Besarti dhe Drenusha si dhe mbarë familja Dobruna dhe farefisi i gjerë.

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333**



KOMUNA E PRIZRENIT
Drejtoria për Shëndetësi



Qendra Kryesore e
Mjekësisë Familjare
Nr.12/4
Me datë: 28.09.2018
Prizren

Në bazë të nenit 8, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria për Shëndetësi e Komunës së Prizrenit dhe Drejtoria e QKMF-së shpall:

KONKURS PUBLIK Për punë dhe detyra specifike

QKMF-QENDRA E MIRËQENJES SË GRUAS (Projekti „Skriningu i kancerit të qafës së mitrës në Komunën e Prizrenit“)

Titulli i vendit të punës: GJINEKOLOG/E
Niveli i pagës: 600 €
Numri : një (1)
Periudha: Njëqind e njëzet (120) ditë, nga 40 orë në javë.

Detvrat kryesore të punës:

- 1.1. Marrja e strishove të PAP testit dhe evidentimi i të dhënave përcjellese të strishos,
- 1.2. Koordinimi i punës me stafin e QMG-së, koordinatorin e projektit dhe stafin e Spitalit Rajonal të Prizrenit,
- 1.3. Raportimi i rregullt i mbarëvajtjes së projektit tek koordinatori i projektit,
- 1.4. Komunikimi profesional dhe bashkëpunimi me donatorët e jashtëm,
- 1.5. Prezentimi në media i projektit nëse shfaqet nevoja.

Kualifikimi arsimor dhe profesional:

Specialist gjinekolog/e përvojë pune nga lëmia e kërkuar.

Dokumentacioni i kërkuar:

- 1.2 Licenca e punës e specialistit Gjinekolog/e,
- 1.2 Çertifikata/ekstrakti i lindjes,
- 1.3 Dëshmi për përvojë pune në lëminë e kërkuar dhe çertifikata për trajnime dhe aftësim profesional.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në QKMF në Prizren, së bashku me dokumentacionin e kërkuar në zyrën nr.101 prej orës 07.00-15.00.

Afati i i Paraqitjes së aplikacioneve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit, nga data 28.09.2018 deri me datën 12.10.2018.

Aplikacionet e dorëzuara pas mbylljes së Konkursit dhe ato të pakompletuara, nuk do të pranohen. Në intervistë me gojë, ftohen vetëm aplikantët nga Lista e ngushtë, e cila hartohet mbi bazën e kriterëve të konkursit.

Dokumentacioni i kërkuar (kopjet e dokumenteve të kërkuesve) duhet të jenë të vërtetuara në Komunë apo te noteri, të njëjtat nuk ju kthehen pas përfundimit të procedurave të konkursit (mbeten në QKMF, për të dëshmuar konkurimin tuaj).



PRIZREN BELEDIYESI
Sağlık Müdürlüğü



Aile Hekimliği
Ana Merkezi
No. 12/4
Tarih: 28.09.2018
Prizren

03/L-212 sayılı İş Kanunu'nun 8. ve 10. maddesine, 1. ve 2. fıkrasına ve 2.3 noktalarına ve Kamu Sektörü'nün Konkurs işlemlerini düzenlemek için 07/2017 - No.lu İdari Yönergesine dayanarak, Prizren Aile Hekimliği Ana Merkezi, belirli iş ve görevlerin tamamlanması için işbu

KAMU KONKUR'unu ilan ediyor.

AHAM-KADIN REFAH MERKEZİ („Prizren Belediyesi'nde rahim ağzı kanseri taraması“ Projeği)

İş yerinin unvanı: JİNEKOLOG
Maaş seviyesi: 600 €
Sayı : bir (1)
Süreç: Yüz yirmi (120) gün, haftada 40 saat.

Ana iş görevleri:

- 1.1. PAP test için sürüntülerin alınması ve sürüntülerin beraberlerindeki verilerin,
- 1.2. Kadın Refahı Merkezi'nin çalışanları, Proje Koordinatörü ve Prizren Bölge Hastanesi personeli ile koordinasyonu,
- 1.3. Projenin ilerlemesi ile ilgili proje koordinatörüne düzenli olarak raporlaması,
- 1.4. Dış donatörlerle profesyonel iletişim ve işbirliği,
- 1.5. Projenin, gerekirse medyalarda sunumu.

Eğitsel ve profesyonel kalifiye:

İstenilen alanda deneyime sahip olan Jinekoloji Uzmanı.

Gereken evraklar:

- 1.2 Jinekoloji Uzmanı İş Ruhsatı,
- 1.2 Doğum Belgesi,
- 1.3 İstenilen alanda deneyim için kanıt ve eğitim ve mesleki eğitim için sertifikalar.

Başvuru formları Prizren AHAM-de alınır ve aranılan diğer evraklarla birlikte 101 No-lu ofiste saat 07:00 ile 15:00 arası teslim edilir.

Başvuru formların son teslim tarihi yayınlandığı günden itibaren 15 gündür, yani 28.09.2018 ile 12.10.2018 tarihler arasında'dır.

Konkur kapandıktan sonra teslim edilen ve komple olmayan başvuru formları dikkate alınmayacaktır.

Sözlü mülakatta, Konkur kriterlerine göre hazırlanan, sadece Yakın Listeden başvuranlar davet edilecektir.

Aranılan evrakların fotokopileri Belediye veya Noter onaylı olmaları gerekir. Bu evraklar, Konkur işlemlerinin tamamlanması sonrası iyade edilmeyecektir (sizin Konkur'a katıldığınızı kanıtlamak için AHAM dosyalarında kalacaktır).



OŠTINA PRIZREN
DIREKTORAT ZA ZDRASTVO



Glavni Centar
Porodične Medicine
Br.12/4 Dana: 28.09.2018
Prizren

Na osnovu čl. 8 i čl. 10, paragraf 2, tačka 2.3 Zakona o Radu Br. 03/L-212, i Administrativno Upustvo br.07/2017 o regulisanju Procedura Konkursa na Javnom Sektoru, Direktorat za Zdrastvo Opštine u Prizrenu kao i Direktorat Glavnog Centra Porodične Medicine u Prizrenu objavljuje:

JAVNI KONKURS Za rad i specifični zadaci

GCPM – CENTAR ZA BLAGOSTANJE ŽENA (Projekat „Skriningu za kancer grlića materice u Opštini Prizren“)

Naziv radnog mesta: GINEKOLOG
Nivo plate: 600 €
Broj : jedan (1)
Period: Sto dvadeset (120) dana, po 40 sati dnevno.

Glavni radni zadaci:

- 1.1. Uzimanje brisova za PAP test i evidentiranje popratnih podataka brisova,
- 1.2. Koordiniranje rada sa stafom CBŽ, koordinatorom projekta i stafom Regionalne Bolnice Prizren,
- 1.3. Redovni izveštaj kod koordinatora projekta o napretku projekta,
- 1.4. Profesionalna komunikacija i saradnja sa stranim donatorima,
- 1.5. Prezentacija projekta po medijima, ako se ukaže potreba.

Obrazovne i profesionalne kvalifikacije:

Specijalista ginekologije, radno iskustvo iz tražene oblasti.

Potrebna dokumentacija:

- 1.2 Licenca za rad specijaliste Ginekologije
- 1.2 Izvod iz matične knjige rođenih
- 1.3 Dokaz o radnom iskustvu iz tražene oblasti, kao i Uverenja/Certifikati o treninzima i profesionalnom usavršavanju.

Aplikacije se uzimaju i predaju u GCPM u Prizrenu, zajedno sa potrebnom dokumentacijom, u kancelariji br. 101 od 07.00-15.00.

Rok za prijavu aplikacija je 15 (petnaest dana) dana od dana objavljivanja od dana 28.09.2018 do 12.10.2018.

Aplikacije predate nakon zatvaranja Konkursa, kao i nekompletirane aplikacije, neće se uzeti u obzir. Na usmeni intervju će se pozvati samo kandidati iz užeg spiska, koji će se sastavljati na osnovu kriterijuma konkursa.

Potrebna dokumentacija (kopije traženih dokumenata) treba da bude overena u Opštini ili kod Notera; nakon završetka procedura Konkursa, te dokumente vam nećemo vraćati (ostaće u GCPM kao dokaz da ste konkurisali).

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Sokol Xhemaili nga Shkupi shpallë të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme "Medresa Alaudin" Prishtinë.

► NTH "Te Isa" shpall të pavlefshëm numrin e biznesit 70236686 dhe numrin fiskal 600148226, Skenderaj.

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet të ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë të jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet të ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truallin frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truallin frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

Lëshoj shtëpinë me qira, e cila gjendet në lagjen e "Universiteti" përball rrugës B dhe përball marketit Viva Fresh Store. Shtëpia është 100 metra katror dhe e mobiluar. Është e përshtatshme për zyre dhe banim. Numri kontaktues 049-574-169.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

